



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Didaktikë”

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr.Erleta Çelmeta (Mato)

Prof.Asoc.Dr. Leticja Gusho

Shkurt/ 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
“MASTER PROFESIONAL” NË “DIDAKTIKË”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë,
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Didaktikë”
4	Urdhri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 744 date 05.09.2013 (per miratimin e kuotave)
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senatit Nr 68 date 14.06.2018, Miratuar me shkresë të MASR Nr. Prot. 7238/1, date 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr 290, datë 22.10.2020 <i>IAL ka përcjellënë QSHA shkresën me Nr. 208/4 prot., datë 23.03.2023, për saktësimin e numrit të krediteve në urdhër</i>
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021 11 PAE 1 PAK 2021-2022 11 PAE 1 PAK

Quota

		2022-2023 11 PAE IPAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 30 studente 2021-2022 11 studente 2022-2023 12 studente
19	Komente / të tjera:	-

PERMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadër të akreditimit të programit universitar të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" në Institucionin e Arsimit të Lartë "Aleksandër Moisiu", me vendndodhje në Durrës (UAMD), (në këtë raport, që tani dhe më tutje Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, do të referohet si akronimi 'UAMD'), procesi i vlerësimit u zhvillua në përputhje me agjendën e miratuar bashkërisht të të dy programeve. Raporti pasues përfshin vëzhgimet dhe konkluzionet e nxjerra nga analiza e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm i përket programit universitar me kohë të plotë, të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional" në "Didaktikë". Ky program administrohet nga Departamenti i Pedagogjisë, që është në kompetencën e Fakultetit të Edukimit. Për programin e studimit, "Master Profesional" në "Didaktikë", të dhënat janë sa më poshtë vijon:

Licencim: VKM Nr. 744, datë 05.09.2013 (për miratimin e kuotave). Ky program studimi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatjen e programit Master Profesional në "Didaktikë", me Vendim Senati Nr. 68, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7238/1 Prot., datë 31.08.2018. Regjistrimi i formës së diplomës: Urdhër QSHA Nr. 290, datë 22.10.2020. IAL ka përcjellë në QSHA shkresën me Nr. 208/4 prot., datë 23.03.2023, për saktësimin e numrit të krediteve në urdhër. Ky program i ciklit të dytë "Master Profesional", është i organizuar me gjithsej 120 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në tre vitet e fundit ka qenë:

- Për vitin akademik 2020-2021 është 30 studentë
- Për vitin akademik 2021-2022 është 11 studentë
- Për vitin akademik 2022-2023 është 12 studentë

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë, të përcaktuara me VKM nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, për programin e studimit të ciklit të dytë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, FE, DP, për të realizuar takimet në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof.Dr. Erleta Mato dhe Prof.Asoc.Dr. Leticja Gusho. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc. Anilda Beqiraj.

Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm është:

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
- Urdhër i MASH nr. 81, datë 25.02.2013
- VKM nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017
- Rregullore e Sigurimit të Cilësisë, ASCAL

Aktivitetet kryesore të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

Analiza e të dhënave parësore. Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Didaktikë” (2023)¹ i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm, Statuti i UAMD², Rregullore e UAMD³, Rregullore e Fakultetit të Edukimit, paketa e plotë e dokumentacionit të programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit.

Analiza e të dhënave dytësore. Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion. Takimet sipas agjendës së paracaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet janë zhvilluar në datat 10 dhe 11 Tetor 2023. Gjatë këtyre takimeve, u zhvilluan bashkëbiseda të qëllimta dhe vëzhgime. Kështu, u realizuan biseda me

¹ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “RVB Didaktikë”, ASCAL, Dokumenti nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Statuti i Universitetit ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës”, ASCAL, Evidenca nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, ASCAL, Evidenca nr.3. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Carota



Rektoren e UAMD, Drejtuesin e Njesisë Qendrore; bisedë me Dekanin e Fakultetit të Edukimit; bisedë me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, bisedë me stafin akademik të programit të studimit; bisedë me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore, bisedë me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikimit; bisedë me përfaqësues të studentëve të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë"; bisedë me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë, si edhe bisedë me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve.

Vëzhgimet në Institucion. Në të dy ditët e vizitës në Institucion u mundësuan vizitat në auditorët mësimorë, Bibliotekën, mjediset e shërbimeve të studentëve etj. Vlen të theksohet se përgjatë gjithë procesit të vizitës, Institucioni kishte marrë të gjitha masat dhe tregoi disponibilitet shumë të lartë dhe cilësor, si në organizim ashtu dhe në bashkëpunim, për realizimin me sukses të të gjitha staveve të procesit, si edhe duke ju përgjigjur në kohë kërkesave të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti A. Moisiu, është njohur me DRVJ më datë 23.01.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 19/12 prot date 23.01.2024. Universiteti dërgon komente me shkresë zyrtare 222 datë 31.01.2024 .Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.





Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) është themeluar sipas VKM nr.801, datë 20.12.2005 "Për Vendimin e Hapjes së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës". Si njësi kryesore në përbërje të UAMD-së, Fakulteti i Edukimit ofron edhe Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë"⁴. Në Statutin e UAMD⁵-së (nenin 2) theksohet se <i>statuti mbështetet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë...në Republikën e Shqipërisë"</i>, në nenin 3 përcaktohet se <i>misioni i universitetit është që të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane</i>, ndërsa në nenin 4 tregohet se UAMD-ja ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës dhe shkencës për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor si edhe synon zhvillimin e veprimtarisë së tij brenda sistemit arsimor dhe të kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Në Planin Strategjik të Zhvillimit⁶ të UAMD-së (2020-2025) theksohet se UAMD, ka si mision <i>të promovojë Arsimin e Lartë duke shkëmbyer njohuri dhe duke gjeneruar ide të reja dhe moderne, të promovojë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe Universitetit.</i></p> <p>Rezulton se UAMD ofron programe studimi të rëndësishme së veçantë që janë në linjë me interesat kombëtare dhe që synojnë ruajtjen, konsolidimin, si edhe zhvillimin e vlerave më të mira në</p>

⁴ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Lista e Programeve të studimit UAMD", ASCAL, Evidenca nr.10. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Statuti i Universitetit 'Aleksandër Moisiu' Durrës", ASCAL, Evidenca nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025", ASCAL, Evidenca nr.2. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	fushën e edukimit.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë i Fakultetit të Edukimit të UAMD-së dhe hapja e tij është miratuar me VKM nr.744, datë 05.09.2013 "Për hapjen e disa programeve të reja studimore në Universitetin 'Aleksandër Moisiu' Durrës". Programi i studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë të universitetit⁷ që është fusha e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarisë krijuese dhe profesionale.</p> <p>Gjithashtu, në Planin Strategjik të UAMD-së (2020-2025) theksohet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në mësimdhënie dhe gjithëpërfshirje në kërkimin shkencor. Rezulton se Programi i studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" i ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë i UAMD-së ofrohet në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së universitetit, si edhe me qëllimet dhe misionin e tij.</p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit⁸ (në nenin 7) theksohet se <i>veprimtaria e programit të studimit përfshin studime të thelluara në mësimdhënie, mësimnxënie dhe edukimin e të rriturve; studime të thelluara mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien; studime të thelluara në fushën e edukimit të rriturve.</i></p> <p>Në Planin Strategjik të UAMD-së (2020-2025)⁹, lidhur me programet e studimit theksohet se janë përparësi e universitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ nevojat e individit, të shoqërisë, si edhe të tregut të punës; ○ investimi në cilësinë e mësimdhënies; ○ procesi i transferimit të dijeve të harmonizohet me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare. <p>Gjithashtu, një objektivi i rëndësishëm i vendosur për t'u arritur në strategjinë¹⁰ 2020-2025 është edhe favorizimi i metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, si edhe përgatitjen për tregun e punës. Synohet që në vitet 2020-2025, UAMD-ja do të ketë një model të përmirësuar të garantimit të</p>

⁷ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Statuti i Universitetit 'Aleksandër Moisiu' Durrës", ASCAL, Evidenca nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025", ASCAL, Evidenca nr.2. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰ Idem

Guato

Get

	cilësisë së mësimdhënies. Rezulton se Programi i Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" ofrohet në përputhje me kërkesat e Statutit, Strategjisë së Zhvillimit 2020-2025 të UAMD-së, si edhe Rregulloren e Programit të Studimit.			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe i planit të veprimit për zbatimin e saj është miratuar me VKM nr.621, datë 22.10.2021, pra dy vjet përpara hartimit të RVJ-së. Konstatohet se,ndonëse ka pasur kohë të mjaftueshme, në të gjitha dokumentet rregullatorë të UAMD-së nuk ekzistojnë referenca që lidhen me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. <i>Rekomandohet që Rregullorja e Departamentit të Pedagogjisë, si edhe Rregullorja e Programit të Studimit të përditësohen në përputhje me kërkesat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2025.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i Studimit i Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" i përgjigjet fushës së studimit të UAMD-së dhe Fakultetit të Edukimit, si edhe është i hartuar në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillim, Statutit, si edhe Rregullores së UAMD-së, por në të gjithë dokumentacionin rregullator nuk ekzistojnë referenca që lidhen me Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë, si njësi bazë në përbërje të Fakultetit të Edukimit. Departamenti i Pedagogjisë ¹¹ ka në përbërje të tij gjithsej 20 pedagogë: <ul style="list-style-type: none"> ○ 13 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 1 ka titullin

¹¹ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Nr. i personelit efektiv i Dep. Ped", ASCAL, Evidenca nr.50. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>programi studimi në atë fushë.</p>	<p>“Profesor”, 7 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, si edhe 5 kanë gradën “Doktor Shkencash”;</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ 7 personel akademik (PAK), nga të cilët 3 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 3 kanë gradën “Doktor i Shkencave”, ndërsa 1 është me “Master i Shkencave”. <p>Rezulton se personeli akademik që mbulon zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është me përvojë shumëvjeçare në fushën e edukimit. Gjithashtu, nisur nga CV e pedagogëve në përbërje të Departamentit të Pedagogjisë, rezulton se personeli akademik është një kombinim brezash dhe përvojash të larmishme, me kualifikime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", duhet t'i referohemi VKM-së nr.310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, për rastin tonë, <i>fusha e gjerë e studimit</i> përkon me atë që UAMD-së¹² (01-Arsim), <i>fusha e ngushtë e studimit</i> përkon me atë të Fakultetit të Edukimit¹³ (018-Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë arsimin) dhe <i>fusha e detajuar e studimit</i> përkon me të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", (që është 0188Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë arsimin).</p> <p>Programi i Studimit të Ciklit të Dytë"Master Profesional" në "Didaktikë"përkon me nivelin 7/2 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Rezulton se ka harmoni midis fushës së studimit të UAMD-së, fushës së studimit të Fakultetit të Edukimit, si edhe fushës së studimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë"Master Profesional" në "Didaktikë".</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" tregohet në nenin 7 të Rregullores¹⁴ së Programit të Studimit, në të cilën theksohet:</p>

¹²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Statuti i Universitetit 'Aleksandër Moisiu' Durrës”, Neni 1, ASCAL, Evidenca nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Fakultetit të Edukimit”, Neni 46, ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Dosja Master Profesional në Didaktikë”, ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Coar

[Signature]

<p>fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Veprimtaria e MP në “Didaktikë”</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>studime të thelluara në mësimdhënie, mësimnxënie dhe edukimin e të rriturve;</i> ○ <i>studime të thelluara mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien në programin e parashkollorit;</i> ○ <i>studime të thelluara në fushën e edukimit të rriturve.</i> <p>Fusha akademike dhe kërkimore e njësisë bazë (Departamenti i Pedagogjisë) tregohet në nenin 36 të Rregullores¹⁵ së Departamentit, në të cilën tregohet se programet e studimit në fushën e mësuesisë përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ programe “Master Profesional” që formon mësues të arsimit fillor; ○ programe “Master të Ciklit të Dytë” për mësues të arsimit të mesëm, të ulët dhe të lartë. <p>Rekomandohet plotësimi dhe saktësimi i nenit 36 të Rregullores së Departamentit të Pedagogjisë, në të cilën duhet të shtohet shprehja se <i>në fushën akademike të Departamentit të Pedagogjisë përfshihen edhe programe ndërdisiplinore që përfshijnë arsimin.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>Nuk rezultojnë që Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë të ofrojnë “Master Profesional” jashtë profilit të UAMD-së.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Rezultojnë se UAMD-ja mban lidhje me studentët e diplomuar për të marrë në vazhdimësi mendimin e tyre¹⁶, por nuk rezultojnë që UAMD-ja të ofrojë trajnime profesionale me studentët tashmë të diplomuar.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezultojnë se Departamenti i Pedagogjisë, që është njësi përgjegjëse për zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional” në “Didaktikë”, ka përvojën.</i></p>

¹⁵“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë”, ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁶ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore – Udhëzuesi i Karrierës”, ASCAL, Evidenca nr.21. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	<i>kapacitetet, si edhe burimet e duhura akademike për ofrimin e programit të studimit. Programi i Studimit është në përputhje me fushën e veprimtarisë së UAMD-së, si edhe në përputhje me fushën akademike të studimit të Fakultetit të Edukimit dhe të Departamentit të Pedagogjisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Departamenti i Pedagogjisë që mbulon zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet kryesore rregullatorë të institucionit që janë Rregullorja e UAMD-së, Rregullorja e Fakultetit të Edukimit, Rregullorja e Departamentit të Pedagogjisë, si edhe Rregullorja e Programit të studimit. Rregullorja e UAMD¹⁷-së përcakton kriteret kryesore të funksionimit të universitetit në tërësi, duke treguar se institucioni e zhvillon veprimtarinë përmes zbatimit të vendimeve, urdhrave, si edhe udhëzimeve. Kjo rregullore përcakton edhe disiplinimin e marrëdhënieve të organeve dhe autoriteteve drejtuese me njësitë përbërëse të tij. Rregullorja e UAMD-së përcakton se rregulloret e brendshme të njësive kryesore dhe të njësive bazë miratohen nga Senati Akademik, ndërsa rregulloret e brendshme të funksionimit të strukturave ndihmës akademike me karakter administrativ rregullohen përmes rregulloreve të njësive kryesore.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Edukimit¹⁸ përcaktohet se subjekte të rregulloreve të fakultetit janë organet dhe autoritetet drejtuese të</p>

¹⁷ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", ASCAL, Evidenca nr.3. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁸ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Fakultetit të Edukimit", ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	FE, personeli akademik dhe administrativ, këshillat, komisionet, studentët, si edhe bashkëpunëtorët e fakultetit. Gjithashtu, në rregulloren e fakultetit përcaktohen me detaje mënyra e rregullimit dhe e kontrollit të jetës së brendshme të karakterit akademik dhe administrativ të njësisë kryesore dhe asaj bazë.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Rezulton se në kuadër të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues, UAMD-ja ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi prej vitesh me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, ndërsa me detaje këto marrëdhënie tregohen në evidencën nr.53 ¹⁹ .
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj,dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Për zhvillimin e praktikës profesionale për të gjithë studentët që ndjekin programet e studimit që zhvillohen nga Fakulteti i Edukimit pranë UAMD-së, është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ²⁰ me Zyrën Vendore Arsimore Durrës, sipas të cilës përcaktohen modalitetet e kryerjes prej studentëve të praktikave profesionale pranë institucioneve arsimore parauniversitare publike të Qarkut të Durrësit, si edhe të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve. Nisur nga specifika e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", konstatohet se kjo marrëveshje është e mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale që lidhen me programin e studimit.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse	Departamenti i Pedagogjisë, si njësi bazë që mbulon edhe zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master

¹⁹ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD", ASCAL, Evidenca nr.53. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁰ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës", ASCAL, Evidenca nr.67. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Profesional" në "Didaktikë", në fund të çdo viti akademik zhvillon analizën e punës vjetore ²¹ të tij, në të cilën analizohet edhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik, edhe Fakulteti i Edukimit paraqet raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore, në të cilin përfshihet edhe veprimtaria vjetore e Departamentit të Pedagogjisë ²² , Në këto raporte, analizohet ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në lidhje me vitin akademik të përfunduar, së bashku me problematikat e implementimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.			
Konkluzione	<i>Kuadri i përgjithshëm rregullator i UAMD-së është i plotë dhe ekziston një ndarje e qartë e detyrave që duhet të kryejë çdo njësi e institucionit. Në funksion të zbatimit të programit të studimit, ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë brenda dhe jashtë vendit. Në përfundim të çdo viti akademik, nga njësia kryesore dhe njësia bazë, analizohet ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatorë.

²¹ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Raporti Vjetor i Departamentit të Pedagogjisë", ASCAL, Evidenca nr.5.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²² "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Raport mbi Veprimtarinë Mësimore - Shkencore FE, 2021-2022", ASCAL, Evidenca nr.82. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është i organizuar në lëndë mësimore të cilat ndahen në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese, si edhe detyrime përmbyllëse. Përfundimi me sukses i Programit të Studimit parashikon dy vite akademike dhe në përfundim të tij studenti fiton 120 kredite ECTS. Struktura e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është në përputhje me VKM nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit për ciklin e dytë të Master Profesional në "Didaktikë" është i përqendruar në zhvillimin e një sërë shprehjesh të veçanta në fushën e didaktikës. Ky program ka për qëllim ofrimin e njohurive të thelluara dhe aftësive të përparuar në fushën e studimit ose punësimit. Synimi kryesor është të përgatisë mësues me një gamë të gjerë të shprehive dhe aftësive që janë të nevojshme në ushtrimin e profesionit. Në këtë program, studentët përfitojnë njohuri të thelluara dhe kuptim kritik të teorive dhe parimeve akademike në fushën e didaktikës. Përveç kësaj, ata zhvillojnë kompetenca që janë esenciale për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në kontekstin e një fushë të specializuar studimi ose profesionale. Me përqendrim në një trajnim të thelluar akademik dhe profesional, ky program i siguron studentëve një bazë të fortë të dijeve dhe aftësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor i Programit të Studimit²³ të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" përcakton se ngarkesa e praktika profesionale vlerësohet 6 kredite, ndërsa ngarkesa e detyrimeve përmbyllëse vlerësohet me 24 kredite.</p>

²³ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Tabela 10-Plani mësimor MP Didaktikë", ASCAL, Dokumenti nr.12. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, por edhe siç pranohet edhe në RVB, fusha e detajuar e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" përfshin kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë arsimin. Në këtë këndvështrim, programi i studimit është me natyrë ndërdisiplinore dhe GVJ nuk gjen referencë në kriterin 4 të Standardit II.1.</p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi i studimit i Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", referuar Planit Mësimor²⁴ është i organizuar me 120 Kredite dhe mbi 50% të krediteve të lëndëve i shërbejnë formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik.</p> <p>Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, Programi i studimit i Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është program me natyrë ndërdisiplinore dhe unik në sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë shkak, nuk mund të krahasohet me programe të tjera që zhvillohen në fushën e mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në</p>	<p>Konstatohet se UAMD-ja nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë, në kuptim të nenit 84 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Për këtë shkak, kriteri 6 nuk merret në analizë prej grupit të vlerësuesve të jashtëm.</p>

²⁴"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Tabela 10-Plani mësimor MP Didaktikë", ASCAL, Dokumenti nr.12. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Siç është përmendur edhe më sipër në kriterin 5 të këtij standardi, Programi i studimit i Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është program me natyrë ndërdisiplinore dhe unik në sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë shkak, nuk mund të krahasohet me programe të tjera që zhvillohen në fushën e mësuesisë.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<p>Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, në përputhje edhe me RVB-në, Kodi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është 72MP0188S dhe është në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, Programi i Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" përkon me nivelin 7/2 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Nga këqyrja e Planit Mësimor²⁵ të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", rezulton se të gjitha programet lëndore nuk janë të pajisura me kodet e lëndëve. Megjithatë, në dokumentet e paraqitura në momentin e kërkesës për hapjen²⁶ e programit të studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" në vitin 2012, të gjitha lëndët mësimore të propozuara kanë pasur kodet e tyre.</p> <p>Rekomandohet Departamenti i Pedagogjisë që të ndërtojë/përshtatë një sistem kodifikimi të lëndëve, në bazë të të cilit të bëhet kodifikimi i çdo lënde të veçantë.</p>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në	Nuk rezulton që Programi i Studimit i Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" të jetë program i përbashkët i dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj.

²⁵ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Tabela 10-Plani mësimor MP Didaktikë", ASCAL, Dokumenti nr.12. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁶ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kodifikimi i programit është bërë në përputhje me kërkesat ligjore. Programet lëndore nuk kanë të treguar kodin e çdo lënde të veçantë: Për këtë është dhënë edhe rekomandimi përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Rezulton se njësia bazë që është përgjegjëse për administrimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" plotëson kërkesat e vendosura në Vendimin e MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", sipas të cilit kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që <i>Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.</i></p> <p>Fakulteti i Edukimit si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 7 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Gjuhës Shqipe; 2. Departamenti i Gjuhëve të Huaja; 3. Departamenti i Letërsisë; 4. Departamenti i Pedagogjisë; 5. Departamenti i Psikologjisë; 6. Departamenti i Sociologjisë;

Auto

[Signature]

	<p>7. Qendra e Edukimit në Vazhdim;</p> <p>Siç është theksuar edhe më sipër në këtë RVJ, Departamenti i Pedagogjisë²⁷ për vitin 2022-2023 ka në përbërje të tij gjithsej 20 pedagogë, nga të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ 13 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 1 ka titullin “Profesor”, 7 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, si edhe 5 kanë gradën “Doktor Shkencash”; ○ 7 personel akademik (PAK), nga të cilët 3 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 3 kanë gradën “Doktor i Shkencave”, ndërsa 1 është me “Master i Shkencave”. <p>Konstatohet se numri i PAE është më se i mjaftueshëm për zhvillimin me sukses të programit të studimit. Gjithashtu, konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë (PAE) që përgjigjet për mbarëvajtjen e zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" mbulon mbi 90% të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi. Nga Tabela 12²⁸ rezulton se ngarkesa mësimore e plotë e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është 1710 orë mësimore. Kështu, për vitin 2022-2023, personeli PAE ka zhvilluar gjithsej 1.575 orë (ose 92.1% e totalit), ndërsa PAK ka zhvilluar gjithsej 135 orë (ose 7.9% të totalit).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqëruar, rezultoi se Departamenti i Pedagogjisë, si njësi përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë", nuk angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, por e mbulon këtë veprimtari me burimet e brendshme. Gjithashtu, rezultoi se nisur nga veçoritë e programit të studimit, prej DP mundësohen vetëm praktika profesionale, ndërsa nuk planifikohen dhe as realizohen praktika laboratorike dhe klinike.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse</p>	<p>Neni 14 i Rregullores²⁹ së Departamentit të Pedagogjisë përcakton se roli i Koordinatorit të programit të studimit është i</p>

²⁷ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Nr i personelit efektiv i Dep Ped”, ASCAL, Evidenca nr.50. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁸ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 12 - Titullar pedagog-lëndë MP Didaktikë”, ASCAL, Dokumenti nr.13. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

²⁹ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë”, ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>detyrueshëm. Megjithatë, nga vizita në institucion, nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, si edhe nga ajo çfarë është paraqitur në RVB, rezultoi se Departamenti i Pedagogjisë nuk ka caktuar ndonjë person specifik për rolin e Koordinatorit të programit të studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" dhe që të ketë edhe përgjegjësinë për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Rolin e Koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ecurisë së programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", e kryen në fakt Drejtuesi i Departamentit të Pedagogjisë.</p> <p>Rekomandohet caktimi dhe emërimi i një personeli akademik efektiv për rolin e Koordinatorit të Programit të Studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Pedagogjisë, si njësi bazë e caktuar për zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Rezulton se nuk është caktuar një Koordinator për programin e studimit; për këtë është dhënë edhe rekomandimi përkatës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit</p>	<p>Informacionet më të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" gjenden në dokumentet kryesore rregullatorë të UAMD-së dhe të njësive kryesore/bazë, që më poshtë renditen sipas shkallës hierarkike të tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Rregullorja e UAMD³⁰-së;

³⁰ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", ASCAL, Evidenca nr.3. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




të studimit.	<ul style="list-style-type: none"> ○ Rregullorja e Fakultetit të Edukimit³¹; ○ Rregullorja e Departamentit të Pedagogjisë³²; ○ Rregullorja e Programit të Studimit³³. <p>Përveç dokumenteve të mësipërme rregullatorë, të dhëna më të detajuara jepen edhe në planin mësimor³⁴ të programit të studimit, kurrikulën, si edhe në syllabuset e lëndëve.</p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani Mësimor ³⁵ i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" përmban në pjesën hyrëse objektivat e programit të studimit dhe më pas në planin mësimor tregohet semestri ku zhvillohet lënda, struktura e lëndës, emri i lëndës, ngarkesa mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, kategorinë ku përfshihet lënda (A-E). Gjithashtu, plani mësimor përcakton edhe numrin e lejueshëm të krediteve për çdo lëndë, si edhe orët mësimore që do të zhvillohen në auditor dhe jashtë tij.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullorja ³⁶ e Departamentit të Pedagogjisë përcakton rregullat që duhet të ndiqen nga studentët lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve. Më me detaje, pranimi në programet e studimit të ciklit të parë dhe planifikimi i kuotave rregullohen me nenin 40 të rregullores, ndërsa transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i diplomave rregullohen me nenin 43 të rregullores. Gjithashtu, studentët e interesuar mund të informohen mbi kriteret e përmendura më sipër edhe përmes informacionit të dhënë në faqen zyrtare të UAMD-së.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore	Dokumentacioni i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" përmban edhe programet lëndore ³⁷ (syllabuset), të cilat përmbajnë të gjitha elementët e kërkuar nga VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të

³¹ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Fakultetit të Edukimit", ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³² "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë", ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³³"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁴"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Plani mësimor & Kurrikula Didaktikë, MP 2022", ASCAL, Evidenca nr.35. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁵ Po aty

³⁶ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë", ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

³⁷"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Plani mësimor & Kurrikula Didaktikë, MP 2022", ASCAL, Evidenca nr.35. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

(syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Në të gjitha syllabuset, të cilat janë hartuar sipas anekseve të VKM-sa nr.41/2018, tregohet emrin i lëndës, pedagogu përgjegjës, ngarkesa, tipologjia e lëndës, viti akademik, lloji i lëndës, temat themelore, qëllimet dhe rezultatet e të nxënit, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, si edhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Rezultoni nga kontrolli i dokumentacionit të paraqitur ³⁸ se përmbajtja e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është përmirësuar/riorganizuar në vitin 2018 në masën 20%, si edhe është marrë miratimi nga strukturat përkatëse për këtë përditësim të programit të studimit. Dokumentacioni i plotë për këtë riorganizim ruhet në arkivin e Fakultetit të Edukimit.			
Konkluzione	<i>Gjithë dokumentacioni i plotë rregullator i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" përmban gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin me sukses të programit të studimit të tillë si planin mësimor, ngarkesën mësimore, programet lëndore, si edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Rezultoni, gjithashtu, se programi i studimit i është nënshtruar përditësimit/riorganizimit në vitin 2018.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi,	Referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), Programi

³⁸ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Lista e Programeve të studimit UAMD", ASCAL, Evidenca nr.10. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>i Studimit i Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" pozicionohet në nivelin 7-2 të KSHK-së. Gjithashtu, në Rregulloren e programit të studimit³⁹ në nenet 6 dhe 7 të saj përcaktohet se "Master Profesional" në "Didaktikë" synon një kualifikim më të thelluar teorik/praktik të studentëve krahasuar me ciklin e parë, si edhe synon, gjithashtu, studime të thelluara për mësimdhënien, mësimnxënien, si edhe edukimin e të rriturve.</p> <p>I konceptuar në këtë mënyrë, përfundimi me sukses i programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë"u jep të diplomuarve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues për studentët që përfundojnë nivelin "Master Profesional"; ○ mundësinë për të ndjekur "Master Shkencor" të nivelit 7-1, duke pasur privilegjin që një pjesë të krediteve të "Master Profesional" të nivelit 7-2 të njihen në nivelin 7-1 të KSHK-së.
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Referuar programeve lëndore⁴⁰ (syllabuseve) rezulton se shpërndarja e krediteve për lëndët e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si edhe është në harmoni me kërkesat e Shtojcës I të kësaj VKM-je. Kështu, Programi i Studimit përcakton:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ për lëndët bazë 12 ECTS ose 10.0% të krediteve totale; ○ për lëndët karakterizuese 48 ECTS ose 40.0% të krediteve totale; për lëndët ndërdisiplinore përcakton 24 ECTS ose 20.0% të krediteve totale; ○ për lëndët plotësuese përcakton 12 ECTS ose 10.0% të krediteve totale; ○ për detyrimet përmbyllëse përcakton 24 ECTS ose 20.0% të krediteve totale. <p>Rezulton se lloji i lëndëve që zhvillohen dhe shpërndarja e tyre përgjatë 2 viteve dhe 4 semestrave mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>

³⁹ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁰ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Plani mësimor & Kurrikula Didaktikë, MP 2022", ASCAL, Evidenca nr.35. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e Planit Mësimor⁴¹ të programit të studimit përcakton se përqindja e lëndëve karakterizuese është në nivelin 40% (që është përqindja më e lartë e lejuar për këto lloj lëndësh). Gjithashtu, llojet e lëndëve që zhvillohen janë në përputhje me profilin e programit të studimit.</p> <p>Në dokumentacionin shoqërues të RVB-së nuk janë paraqitur referenca që tregojnë përafrimin e strukturës së programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), Programi i Studimit i Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" pozicionohet në nivelin 7-2 të KSHK-së. Gjithashtu, në Rregulloren e programit të studimit⁴² në nenet 6 dhe 7 të saj përcaktohet se "Master Profesional" në "Didaktikë" synon një kualifikim më të thelluar teoriko/praktik të studentëve krahasuar me ciklin e parë, si edhe synon, gjithashtu, studime të thelluara për mësimdhënien, nxënien, si edhe edukimin e të rriturve. I konceptuar në këtë mënyrë, përfundimi me sukses i programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" u jep të diplomuarve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues për studentët që përfundojnë nivelin “Master Profesional”; ○ mundësinë për të ndjekur “Master Shkencor” të nivelit 7-1, duke pasur privilegjin që një pjesë të krediteve të “Master Profesional” të nivelit 7-2 të njihen në nivelin 7-1 të KSHK-së.
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e</p>	<p>Siç është theksuar edhe më sipër në këtë RVJ, përmbajtja e programeve lëndore të programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është përmirësuar/riorganizuar në vitin 2018 në masën 20%. Pas vizitës në institucion, por edhe pas takimit me stafin akademik që zhvillon programin e studimit dhe me studentë, u konstatua se</p>

⁴¹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 10-Plani mësimor MP Didaktikë”, ASCAL, Dokumenti nr.12. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Dosja Master Profesional në Didaktikë”, ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Guato

[Signature]

tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	literatura bazë dhe ajo ndihmëse është përshtatur/ndryshuar, duke marrë për bazë literaturën e viteve të fundit.			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" bazohet në VKM-në nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar. Në Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë ⁴³ , si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit ⁴⁴ parashikohen aftësitë dhe kompetencat që do të përfitojnë studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përfundimi me sukses i programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" u jep të diplomuarve: <ul style="list-style-type: none"> ○ mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës në ato pozicione që parashikon kuadri ligjor ekzistues për studentët që përfundojnë nivelin "Master Profesional"; ○ mundësinë për të ndjekur "Master Shkencor" të nivelit 7-1, duke pasur privilegjin që një pjesë të krediteve të "Master Profesional" të nivelit 7-2 të njihen në nivelin 7-1 të KSHK-së. 			
Konkluzione	<p><i>Përfundimi me sukses i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" u mundëson studentëve që të vijojnë plotësimin e profilit të tyre akademik për në nivelet më të larta të kornizës shqiptare të kualifikimeve (nivelet 7-2 dhe 8), apo u jep atyre mundësinë për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës.</i></p> <p><i>Programi i studimit ka një raport të kënaqshëm teori-praktikë dhe programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me qëllim fitimin e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁴³ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë", ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁴"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Arb

[Signature]

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Pas vizitës në institucion, por edhe pas takimit me pjesëtarë të strukturave drejtuese dhe personel akademik të Departamentit të Pedagogjisë, rezulton se pranë UAMD-së funksionon Shoqata Alumni ⁴⁵ në të cilën marrin pjesë ish-studentët e diplomuar dhe me të cilët organizohen takime ⁴⁶ periodike. Gjithashtu, Departamenti i Pedagogjisë, në funksion të përmirësimit të këtij programi studimi mban kontakte dhe konsultohet me studentët e diplomuar në këtë program dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Siç është përmendur edhe në RVB, studentët kanë përfaqësuesin e tyre në komisione të ndryshme ku mund të shprehin mendimet e studentëve për përmirësimin e programeve të studimeve. Gjithashtu, në UAMD organizohet çdo vit një proces anketimi ⁴⁷ në të cilin merren mendimet e tyre në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet	Siç është përmendur edhe më parë në këtë RVJ, programi i studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është ndryshuar/modifikuar në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, me qëllim kryesor përshtatjen e programeve lëndore në përputhje me planin

⁴⁵ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet", ASCAL, Evidenca nr.22. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁶ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Takime_Raport Shoqata Alumni", ASCAL, Evidenca nr.23. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁴⁷ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin", ASCAL, Evidenca nr.14. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>



dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	strategjik të institucionit dhe me ndryshimet ligjore.			
Konkluzione	<i>Departamenti i Pedagogjisë, në rolin e njësisë përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit, përshtat në vijimësi përmbajtjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, duke qenë në konsultim të vazhdueshëm me aktorë të tjerë të interesuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Në Rregulloren e programit të studimit⁴⁸ në nenet 6 dhe 7 të saj përcaktohet se "Master Profesional" në "Didaktikë" synon një kualifikim më të thelluar teoriko/praktik të studentëve krahasuar me ciklin e parë, si edhe synon, gjithashtu, studime të thelluara për mësimdhënien, mësimnxënien, si edhe edukimin e të rriturve. Në rregulloren e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" nuk ka referenca për kërkimin shkencor. Theksojmë se në dokumentacionin shoqërues të RVB-së është paraqitur vetëm një rregullore e vitit 2015.</p> <p>Rekomandohet përditësimi/amendimi i Rregullores së Programit të Studimit me qëllim përditësimin e saj në bazë të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë..." dhe të akteve të shumta nënligjore të dala në zbatim të ligjit, ku të përfshihen edhe objektivat e programit të studimit në fushën e kërkimit shkencor.</p>

⁴⁸ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Pranë UAMD-së prej datës 30.05.2018 funksionon <i>Rregullorja e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor</i>⁴⁹. Baza e të dhënave mundëson monitorimin në kohë reale të veprimtarisë kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD-së, si edhe rankimin vjetor të njësive, bazuar në këtë vlerësim.</p> <p>Sipas rregullores, organi më i lartë i kërkimit shkencor në UAMD është Këshilli i Kërkimit Shkencor. Gjithashtu, çdo departament cakton nga personeli akademik i tij një “Koordinator për kërkimin”. Gjatë vlerësimit të jashtëm, koordinatori i njësive bazë është person kontakti që ndjek hedhjen e të dhënave në portalin kombëtar.</p> <p>Mbi bazën e të dhënave të kërkimit shkencor bëhen analiza në njësitë bazë dhe ato kryesore të UAMD. Këshilli i Kërkimit Shkencor, si institucion i vlerësimit të brendshëm të cilësisë së kërkimit shkencor bën, në prani të koordinatorëve të kërkimit të njësive bazë, vlerësimin e përvitshëm dhe rankimin e njësive të UAMD.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në RVB për periudhën e katër viteve të fundit, Fakulteti i Edukimit/Departamenti i Pedagogjisë kanë organizuar së bashku me organizatat studentore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Konferencën e dytë studentore “Studentët dhe kërkimi shkencor”, datë 30 Maj 2019. ○ Konferencën e parë studentore “Edukimi, mësuesi dhe perspektivat e së ardhmes, datë 2 Dhjetor 2022.
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacioni shoqërues i RVB-së, rezulton se në Pasqyrën Financiare të UAMD-së gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) është i pasqyruar <i>Granti për kërkim dhe kontratat</i>. Gjithashtu, nga bisedat dhe takimet në institucion me personelin akademik që mbulon zhvillimin dhe administrimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", rezulton se Departamenti i Pedagogjisë mbulon një pjesë të shpenzimeve për financimin e projekteve kërkimore-shkencore, si edhe botimin e artikujve në revista të indeksuara apo me faktor impakti.</p>

⁴⁹ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor”, ASCAL, Evidenca nr.84. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Euro



	<p>Fondi i kërkimit shkencor është i përvitshëm dhe akordohet nga Bordi i Administrimit përmes fondeve të dedikuara kërkimit shkencor. Për t'iu përgjigjur kërkesave të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH", sipas të cilit kërkimi shkencor është kriter i vlerësimit institucional, rankimit dhe financimit të IAL-ve, UAMD⁵⁰ në buxhet ka parashikuar "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", në tre zëra, që janë: "për kërkimin shkencor bazë" (1) "për veprimtaritë shkencore" (2) dhe "për botime" (3).</p>			
Konkluzione	<p><i>Kërkimi shkencor në UAMD/FE/DP funksionon në bazët Rregullore të mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Departamenti i Pedagogjisë mbulon një pjesë të shpenzimeve për financimin e projekteve kërkimore-shkencore, si edhe botimin e artikujve në revista të indeksuara apo me faktor impakti.</i></p> <p><i>UAMD-ja ka parashikuar "Fondin bazë për kërkimin shkencor dhe veprimtaritë shkencore", "për kërkimin shkencor bazë", "për veprimtaritë shkencore" si edhe "për botime".</i></p> <p><i>Është dhënë edhe rekomandimi përkatës për përditësimin e Rregullores së Programit të Studimit me qëllim përditësimin e saj në bazë të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë..." dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të ligjit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja	Nga bisedat e zhvilluara në Institucion, u konstatua se njësia përgjegjëse për këtë program ndërmerr një rol të rëndësishëm në mbështetjen e grupeve lëndore dhe është gjithmonë në përpjekje për të realizuar projekte inovative kërkimore-shkencore. Kjo njësi

⁵⁰ Informacion i marrë nga faqja zyrtare e UAMD-së.

dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	koordinon dhe inkurajon bashkëpunimin e ngushtë me strukturat kërkimore të tjera brenda dhe jashtë fakultetit, duke synuar realizimin e objektivave të përcaktuara në programin e studimit nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të kërkimit shkencor.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Siç është paraqitur edhe në RVB, Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë ka organizuar projekte, konferenca ⁵¹ , si edhe fushata kombëtare/lokale në përputhje me planin strategjik të UAMD-së, ku janë angazhuar personel akademik i vetë universitetit, personel akademik i ftuar, studentë, apo edhe aktorë të tjerë të interesuar. Rezulton se nuk ka pasur kërkesa prej personave të interesuar kundrejt Fakulteti i Edukimit/Departamentit të Pedagogjisë për të kryer analiza apo studime me karakter kërkimor-shkencor.
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Siç është përmendur edhe në RVB, Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë ka organizuar projekte, konferenca ⁵² , si edhe fushata kombëtare/lokale në përputhje me planin strategjik të UAMD-së, ku janë angazhuar personel akademik i vetë universitetit, personel akademik i ftuar, studentë, apo edhe aktorë të tjerë të interesuar.
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit në "Didaktikë" synon të sigurojë se studentët janë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u bërë profesionistë të suksesshëm dhe për të përmbushur kërkesat e licencimit në fushën e tyre të specializimit.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme	Për sa i përket programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Didaktikë", njësia përgjegjëse ka një qasje të përgjegjshme dhe të përshtatshme ndaj rekomandimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale dhe rrjetet profesionale. Kjo njësi jo vetëm që i merr parasysh këto rekomandime, por gjithashtu i zbatoi ato në zhvillimin e programit të studimit.

⁵¹"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Njoftime për konferencat shkencore", ASCAL, Evidenca 72. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵²"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Njoftime për konferencat shkencore", ASCAL, Evidenca 72. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.				
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit “Didaktikë” është në përputhje me aktet ligjore vendore ⁵³ dhe rekomandimet ndërkombëtare, duke përfshirë direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian. Këto përfshijnë, për shembull, “Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU” (Direktiva për Kualifikimet Profesionale, 2005/36/EU). Kjo lidhje me legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare tregon se programi i studimit është i përshtatshëm për të përgatitur profesionistë në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht për profesionet e rregulluara.			
Konkluzione	<i>Kjo njësi koordinon dhe inkurajon bashkëpunimin e ngushtë me strukturat kërkimore të tjera brenda dhe jashtë fakultetit, duke synuar realizimin e objektivave të përcaktuara në programin e studimit nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të kërkimit shkencor. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

⁵³Ligj. Nr.10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”

Gaet

[Signature]

<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë⁵⁴ (neni 46) përcaktohet se çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje, në mënyrat si më poshtë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ orë leksione; ○ orë seminare; ○ orë mësimi të integruara leksione me seminarët; ○ orë ushtrime; ○ orë laborator; ○ projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; ○ provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; ○ formën e praktikës profesionale të zhvilluar në auditor; ○ formën e praktikës profesionale të zhvilluar në laboratorë dhe/ose institucione/kompani me të cilat Departamenti i Pedagogjisë ka marrëveshje bashkëpunimi dhe/ose në ente publike/private të zgjedhura nga vetë studenti dhe të dakordësuara me pedagogun përkatës të praktikës; ○ çdo formë tjetër të miratuar nga njësia kryesore. <p>Nga takimet e zhvilluara në institucion, por edhe në bisedat me pedagogë dhe studentë, rezultoi se gjatë zhvillimit të mësimdhënies përdoren edhe mjete audio vizuale si laptop-e, video-projektorë, të cilët përdoren jo vetëm nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup, apo edhe atyre individuale.</p> <p>Gjithashtu, gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, është përdorur edhe mësimdhënia online që, me gjithë vështirësitë e veta, është finalizuar me sukses.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Rezulton nga takimet e zhvilluara në institucion me staf akademik dhe studentë, se ka një prirje të përgjithshme për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies, duke përdorur edhe teknika të përvetësuara gjatë programeve të shkëmbimit me universitetet partnere jashtë vendit. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik synon zbatimin me sukses të metodave të mësimdhënies me në qendër studentin. Për shkak së metodat e reja të mësimdhënies nuk janë përfshirë në dokumentet rregullatorë të programit të studimit.</p>
	<p><i>Rekomandohet që përdorimi i metodave të reja të</i></p>

⁵⁴ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë", ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Osseto

Set

	<i>mësimdhënies dhe të të nxënit të përfshihet në Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë, si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe që lidhet me performancën e stafit akademik, kryesisht nisur nga mobiliteti ⁵⁵ i personelit akademik dhe nga përmbajtja e CV-ve të paraqitura të personelit akademik, konstatohet se personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse. Siç edhe përmendet në RVB, organizimi i konferencave dhe seminareve shkencore në partneritet me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit, ka krijuar mundësi që personeli akademik të shkëmbejë përvojë, mendime dhe literaturë në fushat e tyre të ekspertizës.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Rezulton nga krahasimi i CV-ve të personelit akademik të Departamentit të Pedagogjisë me llojin e lëndës ⁵⁶ që zhvillon çdo PAE dhe PAK, se zhvillimi i lëndëve bëhet në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre, si edhe çdo PAE/PAK e zhvillon mësimdhënien sipas përvojës vetjake dhe sipas kërkesave të dokumenteve rregullatorë të miratuara të njësisë kryesore/bazë. Kodi i Etikës ⁵⁷ i UAMD-së i miratuar në vitin 2012, ka vendosur mënyra të detyrueshme sjelljeje nga personeli akademik, e parashikuar kjo në nenin 4 të kodit, si kundrejt njëri-tjetrit, ashtu edhe kundrejt studentëve, shkelja e të cilave pas sjell pasoja për të gjitha palët e përfshira.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e	Nga vizita në institucion, nga takime me grupe të ndryshme studentësh, por edhe nga konsultimi me dokumentacionin e paraqitur në RVB, konstatohet se për vlerësimin e procesit dhe të formave dhe të metodave të mësimdhënies merret edhe

⁵⁵ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Mobilitetet e stafit akademik dhe studentëve D.Pedagogjisë”, ASCAL, Evidenca nr.68. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁶“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Dosja Master Profesional në Didaktikë”, ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁷ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Kodi i Etikës UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.4. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Caroto



<p>mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>mendimi i studentëve. Forma kryesore e marrjes së mendimit të studentëve është përmes anketimit⁵⁸.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por edhe për të plotësuar kërkesat ligjore, UAMD-ja ka miratuar Rregulloren⁵⁹ për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, e cila synon të përcaktojë funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi, përmes rregullimit dhe standardizimit të vlerësimit të proceseve në UAMD. Kjo rregullore synon, midis të tjerash, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbyshur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë UAMD-së duke garantuar, gjithashtu, se mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në UAMD të jetë në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Rregullorja ka për qëllim, zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Rregullorja përcakton se në nivel fakulteti, përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti); ○ Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.); ○ Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.)
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezulton se personeli akademik, i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e performancës individuale dhe të aftësive mësimdhënëse. Personeli akademik përdor forma të larmishme të mësimdhënies, të të nxënësve, si edhe të transmetimit të dijeve.</i></p>

⁵⁸“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin”, ASCAL, Evidenca nr.14. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁵⁹ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë-E rishikuar”, ASCAL, Evidenca nr.13. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<i>Këto forma i nënshtrohen përmirësimeve të vazhdueshme nga një personel akademik që zhvillon ato lëndë mësimore që janë në përputhje të ngushtë me formimin dhe kualifikimin shkencor të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret, mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, si edhe aftësive profesionale të studentëve, parashikohet në dokumentet rregullatorë të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Rregulloren e Departamentit⁶⁰ të Pedagogjisë; ○ Rregulloren e Programit⁶¹ të Studimit. <p>Neni 54 i Rregullores së Departamentit të Pedagogjisë përcakton se forma e vetme e kontrollit të dijes në UAMD është provimi me shkrim. Më pas, në nenin 54 tregohet sistemi i vlerësimit me pikë, nota kaluese më e ulët, si edhe mënyra e vlerësimit përfundimtar, e cila përlllogaritet si shumë e ponderuar e vlerësimeve të provimit të ndërmjetëm, atij përfundimtar, si edhe të detyrave/projekteve/eseve/aktivizimit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, mënyra e vlerësimit të njohurive dhe dijeve të studentëve tregohet në nenin 17 të rregullores. Në këtë nen, përveç detyrimit të pedagogëve që të informojnë studentët për mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe të njohurive, përcaktohet se kontrolli i dijeve mund të bëhet</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Me shkrim, me gojë, ose i kombinuar; ○ Me detyra kursi ose projekte; ○ Me punime të pavarura me shkrim ose prezantime.

⁶⁰ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë", ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶¹"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>Duket qartë që neni 54 i rregullores së departamentit (ku përcaktohet se forma e vetme e kontrollit të dijeve në UAMD është provimi me shkrim) ndryshon nga neni 17 i rregullores së programit të studimit (ku përcaktohet se kontrolli i dijeve mund të bëhet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar).</p> <p>Kriteret, mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale tregohet në çdo program lëndor dhe bëhet i njohur nga pedagogu që zhvillon lëndën prej prezantimit të parë me pedagogun.</p> <p><i>Rekomandohet rregullimi i nenit 54 të Rregullores së Departamentit të Pedagogjisë, në atë mënyrë që të mundësohet harmonizimi i nenit 54 të saj me nenin 17 të rregullores së programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se në të gjitha programet lëndore⁶² (syllabuset), në një rubrikë të veçantë tregohet edhe forma e kontrollit të dijeve, vlerësimi i frekuentimit, si edhe mënyra e realizimit të kontrollit të vazhdueshëm. Në këtë rubrikë jepen edhe mënyra e përlogaritjes së vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Menjëherë pas prezantimit të lëndës prej pedagogut në fillim të vitit akademik, studentëve u bëhet e njohur edhe metodologjia e plotë dhe e detajuar e mënyrës së vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Mënyrat e ndryshme të testimit dhe të vlerësimit të njohurive tregohen në nenin 17 të Rregullores së Programit të Studimit⁶³, ku përcaktohet se kontrolli i dijeve mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Me shkrim, me gojë, ose i kombinuar; ○ Me detyra kursi ose projekte; ○ Me punime të pavarura me shkrim ose prezantime. <p>Përveç mënyrës së treguar në mënyrë të përgjithshme në nenin 17 të rregullores për vlerësimin e dijeve dhe njohurive, çdo pedagog i veçantë gjatë hartimit dhe miratimit të programeve lëndore⁶⁴ përcakton edhe mënyrën konkrete të vlerësimit për</p>

⁶² "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Kurrikula + RVB + Syllabuse", ASCAL, Dokumenti nr.108. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶³ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁴ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Kurrikula + RVB + Syllabuse", ASCAL, Dokumenti nr.108. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	çdo lëndë, duke marrë për bazë specifikat dhe kategorinë e lëndëve që zhvillohen.			
Konkluzione	<i>Gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", për vlerësimin e studentëve, përdoren kritere të qarta dhe mënyra të larmishme të testimit e vlerësimit të njohurive. Çdo dokument që përmban kriteret e testimit dhe të vlerësimit të njohurive është i hapur dhe i njohur për studentët. Departamenti i Pedagogjisë inkurajon përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në UAMD, siç është treguar edhe më sipër në këtë RVJ gjatë analizës së kriterëve të mëparshme, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve, si edhe aftësive profesionale të studentëve parashikohen kryesisht në Rregulloren e Departamentit⁶⁵ të Pedagogjisë në nenin 54 të saj (Vlerësimi i studentëve). Në këtë nen, përcaktohet se vlerësimi i dijeve dhe njohurive bëhet përgjatë gjithë vitit akademik përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Zhvillimit të provimit të ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë/tetë të semestrit dhe që përmban 40% të vlerësimit përfundimtar; ○ Zhvillimit të provimit përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë/gjashtëmbëdhjetë të semestrit dhe që përmban 50% të vlerësimit përfundimtar; ○ Detyrave/projekteve/eseve/aktivizimit të cilat zhvillohen apo vlerësohen gjatë gjithë semestrit dhe që përmbajnë

⁶⁵ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë", ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Gueto

[Signature]

	<p>10% të vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Çdo pedagog i veçantë gjatë hartimit, miratimit, si edhe zbatimit të programeve lëndore⁶⁶, përcakton edhe mënyra të tjera specifike të vlerësimit për çdo lëndë, duke marrë për bazë specifikat dhe kategorinë e lëndëve që zhvillohen.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Rezulton se në UAMD, sidomos në periudhën e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19 por edhe pas saj, krahas vlerësimit tradicional me shkrim në auditor është vënë në zbatim sistemi elektronik i testimit dhe vlerësimit, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjes⁶⁷ së nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) për përdorimin e sistemit CleanScore, diçka që rrit transparencën, lehtëson procesin e vlerësimit dhe eliminon abuzimet e mundshme.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Rezulton se mënyra e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentëve, gjatë zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", por edhe vlerësimi përfundimtar i studentëve, bëhet si edhe është përcaktuar në çdo program lëndor⁶⁸dhe që është bërë publike përpara fillimit të vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, si edhe nga takimet me personel akademik të Departamentit të Pedagogjisë dhe me studentë që ndjekin programin e studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", u konstatua se pedagogët e lëndëve që përfshihen në zhvillimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", në mënyrë të vazhduar përgjatë gjithë vitit shkollor, u japin komente studentëve, me shkrim ose me gojë, për çdo etapë të vlerësimit të vazhduar (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, projekt, ese), me qëllim përmirësimin e performancës së studentëve në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik</p>	<p>Përcaktimi i nocionit të plagjiaturës, mënyrat e shmangies së saj, si edhe penalitetet që jepen për çdo rast konstatimi të</p>

⁶⁶ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Kurrikula + RVB + Syllabuse", ASCAL, Dokumenti nr.108. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁷"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Përdorimi i Cleanscore", ASCAL, Evidenca nr.96. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁶⁸"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Kurrikula + RVB + Syllabuse", ASCAL, Dokumenti nr.108. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>plagjiaturës, jepen në nenin 23 të Kodit të Etikës të UAMD-së⁶⁹. Gjithashtu, po në këtë nen (23/2) është përcaktuar detyrimi i institucionit për të siguruar programe softuerike që kontrollojnë në mënyrë automatike për plagjiaturë të mundshme në detyrat e kursit, projektet, si edhe esetë e paraqitura për marrjen e diplomave "Bachelor", apo "Master".</p> <p>Rregullorja⁷⁰ e Fakultetit të Edukimit, në nenet 67 dhe 68 të saj,parashikon mënyrat dhe procedurat që duhet të ndiqen prej pedagogëve të lëndëve konkrete,për të shmangur kopjimin prej studentëve gjatë zhvillimit të provimeve në lëndët që përfshihen në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë".</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në analizën e kriterëve të mëparshme në këtë RVJ, mënyra e zhvillimit të provimit përcaktohet në nenin 67 dhe 68 të Rregullores⁷¹ së Fakultetit të Edukimit, ndërsa në nenin 69 të rregullores tregohet procedura që duhet të ndjekin studentët për ankimimin e procedurave të ndjekura, apo edhe për ankimimin e rezultateve të provimeve.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në analizën e kriterëve të mëparshme në këtë RVJ, mënyra e zhvillimit të provimit përcaktohet në nenin 67 dhe 68 të Rregullores së Fakultetit të Edukimit, ndërsa në nenin 69 të rregullores tregohet procedura që duhet të ndjekin studentët për ankimimin e procedurave të ndjekura, apo edhe për ankimimin e rezultateve të provimeve.</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e</p>	<p>Siç u përmend edhe në analizën e kriterëve të mësipërme⁶ dhe 7, në nenin 69të Rregullores⁷² së Fakultetit të Edukimit tregohet procedura që duhet të ndjekin studentët për ankimimin e procedurave të ndjekura apo për ankimimin e rezultateve të provimeve. Ankesa e studentit i drejtohet me shkrim drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia delegon ankimin tek drejtuesi i</p>

⁶⁹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Kodi i Etikës UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.4. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁰“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Fakultetit të Edukimit”, ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷¹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Fakultetit të Edukimit”, ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷² “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Fakultetit të Edukimit”, ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>njesisë bazë. Drejtuesi i njesisë bazë i paraqet drejtuesit të njesisë kryesore një relacion shpjegues dhe më pas, drejtuesi i njesisë kryesore vendos miratimin apo refuzimin e ankimit të studentit.</p> <p>Nëse ankimi i studentit miratohet, drejtuesi i njesisë kryesore ngre një komision ad-hoc, i cili ndjek një procedurë të përcaktuar qartë për të ndryshuar apo jo vlerësimin fillestar të studentit. Procedura që ndiqet për raste të tilla, arshivohet sipas kërkesave të përcaktuara në Rregulloren për Qarkullimin dhe Arshivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD⁷³.</p>			
Konkluzione	<p><i>Rezulton se në UAMD, gjatë gjithë procesit të zhvillimit të programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe përmes formave të larmishme.</i></p> <p><i>Provimi përfundimtar zhvillohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë. Gjithashtu, studentët kanë të drejtën e njohjes me vlerësimin dhe të drejtën e ankimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të	Në nenin 6të Rregullores ⁷⁴ së Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", në objektivat e programit, theksohet se programi synon një kualifikim teorik dhe praktik të studentëve krahasuar me nivelin e ciklit të parë, si edhe synon të japë kontribut për ngritjen e cilësisë së

⁷³ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD.", ASCAL, Evidenca nr.127. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁴"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

studentëve.	mësimdhënies dhe ngritjes së standardeve të mësuesit duke bashkëpunuar dhe ndihmuar shkollat që ushtrojnë veprimtari në këtë hallkë të arsimit të nxënësve. Programi mundëson, gjithashtu, studime të thelluara në mësimdhënie, në procesin e të nxënësve, si edhe në fushën e arsimit të të rriturve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Zbatimi i Plani Mësimor ⁷⁵ i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", përmes zhvillimit të lëndëve specifike, parashikon: <ul style="list-style-type: none"> ○ zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit përmes zhvillimit të lëndës Teknologjitë në Edukim. ○ zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën humane dhe sociale, përmes zhvillimit të lëndëve të tilla si Metodatat e Mësimdhënies, Psikologji Edukimi, Shkolla dhe Komuniteti. ○ zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit përmes zhvillimit të lëndëve të tilla si Komunikimi dhe Etika, Edukimi Multikulturor, Edukimi qytetar demokratik.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, qysh prej prezantimit të lëndës prej pedagogut në orën e parë mësimore, studentët janë tëqartë për kompetencat dhe aftësitë që ata duhet të fitojnë dhe zotërojnë. Gjithashtu, në përfundim të programit të çdo lënde, studentët vlerësohen përmes një metode të kombinuar: përmes provimit të ndërmjetëm, përmes provimit përfundimtar, si edhe përmes pjesëmarrjes në detyra kurse, ese, prezantime etj.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion zhvilloi dhe bisedat me studentët e programit të studimit, ku u konstatua se mësimdhënia që zhvillohet në këtë departament, bazohet në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe qëndrimeve të studentëve, duke u ofruar atyre mundësi për zhvillimin e njohurive që lidhen si me përgatitjen e tyre shkencore, ashtu dhe

⁷⁵"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Tabela 10-Plani mësimor MP Didaktikë", ASCAL, Dokumenti nr.12. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>me përgatitjen pedagogjike.</p> <p><i>Rekomandohet që të punohet për të shtuar përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Për këtë qëllim, realizohen diskutime të stafit për ndarjen e përvojave më të mira dhe për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave të fituara përmes mobilitetit të stafit në universitete të tjera evropiane, pjesë e programit Erasmus+. Kjo përfshin sesione bashkëbisedimesh, ku personeli akademik ndan njëri-tjetrin me praktikat më të suksesshme dhe mësimet e nxjerra nga përvojat e tyre të huaja. Ky proces i shkëmbimit të njohurive shërben për të pasuruar ambientin akademik dhe për të siguruar një perspektivë ndërkombëtare në zhvillimin e veprimtarive të universitetit.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit është një ambient ku stimulohet dhe promovohet bashkëpunimi mes departamenteve në realizimin e projekteve inovative. Në këtë kontekst, institucioni aktivisht inkurajon dhe mbështet financiarisht projektet që dalin nga bashkëpunimi midis departamenteve, duke e parë këtë si një mjet të rëndësishëm për të nxitur ide inovative dhe për të përparuar studimet kërkimore nga ana e studentëve. Projektet që lidhen me shkëmbimin e ideve dhe resurseve midis departamenteve shërbejnë si një mjet për të thelluar bashkëpunimin në fusha të ndryshme të zhvillimit të dijes. Përveç kësaj, konferencat studentore ofrojnë një platformë ku studentët mund të paraqesin punën e tyre, duke ndarë idetë e tyre me një audienca të gjerë dhe duke kontribuar kështu në krijimin e një mjedisi të pasur intelektual dhe kulturor në Fakultetin e</p>

Geoto

[Signature]

	Edukimit. Përmes mbështetjes financiare, institucioni shfaq përkushtim ndaj zhvillimit të njohurive dhe idesë inovative të studentëve, krijuan një mjedis të stimulueshëm për rritjen e dijes dhe krijimin e një komuniteti akademik të pasur dhe të përfshirë.			
Konkluzione	<i>Zbatimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", parashikon zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme me natyrë teknike/humane/sociale/komunikuese. Këto aftësi analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Pas konsultimit me dokumentacionin shoqëruar, rezulton se Rregullorja⁷⁶ e Fakultetit të Edukimit në nenet 73-77 përcakton:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ modalitetet që ndiqen për të zgjedhur midis punimit të diplomës apo provimit përfundimtar; ○ modalitetet për t'u regjistruar për provim diplome; ○ përgatitja dhe vlerësimi i tezës së diplomës; ○ mbrojtja e tezës së diplomës; ○ organizimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës; ○ mënyra e pajisjes me diplomën përkatëse, pasi studenti përmbush të gjitha detyrimet akademike. <p>Këto rregulla që janë përcaktuar në rregulloren e Fakultetit të Edukimit duhet të jenë në harmoni me rregullat e paraqitura në Rregulloren e Programit të Studimit⁷⁷. Por rezulton se Rregullorja e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", versioni i hedhur në platformën e</p>

⁷⁶ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Fakultetit të Edukimit", ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁷⁷ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Dosja Master Profesional në Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.31.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>ASCAL-it, është e vitit 2015 dhe në të përcaktohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ struktura e studimeve realizohet në dy vite akademike dhe e ndarë në tre semestra, në përfundim të të cilave studenti fiton 90 kredite (neni 14 i rregullores); ○ teza e diplomës vlerësohet me 13 kredite. <p>Gjithashtu, rezulton se në Planin Mësimor⁷⁸ të programit programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" përcaktohet se teza e diplomës vlerësohet me 24 kredite, diçka që vjen në kundërshtim me rregulloren e programit të studimit, ku teza e diplomës vlerësohet me 13 kredite. Për më tepër, në rregulloren e programit të studimit nuk parashikohet mundësia që studentët të zgjedhin midis tezës së diplomës dhe provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Për sa konstatohet më sipër, Rekomandohet rishikimi dhe përditësimi i Rregullores së Programit të Studentit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", ku të saktësohet, midis të tjerash:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ kohëzgjatja e studimeve është dy vite akademike; ○ numri i krediteve që fiton studenti (120 ECTS); ○ kreditet që fitohen përmes tezës së diplomës (24 ECTS); ○ mundësia e zgjedhjes midis tezës së diplomës dhe provimit të përgjithshëm përfundimtar; ○ kompetencat që fiton studenti në përfundim të programit të studimit.
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Siç edhe përmendet edhe në RVB, kërkesat e çdo studenti që shprehin vullnetin e tyre për të zgjedhur midis zhvillimit të provimit të formimit apo mbrojtjes së temës së diplomës shqyrtohen në Departamentin e Pedagogjisë nga ku dalin edhe listat përfundimtare.</p> <p>Departamenti i Pedagogjisë, nëpërmjet personelit akademik efektiv, organizon seanca orientuese, me qëllim sqarimin dhe udhëzimin e studentëve që do të zhvillojnë provimin e formimit, duke u mbështetur në fondin e përgjithshëm të pyetjeve, të vendosura në departamentin e pedagogjisë. Studentët të cilët do të mbrojnë temë diplome kanë të drejtë që të përcaktojnë vetë temën që do të trajtojnë në punimin e</p>

⁷⁸ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Tabela 10-Plani mësimor MP Didaktikë", ASCAL, Dokumenti nr.12. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	diplomës. Rregulla më të hollësishme për të gjithë procesin e përmendur më sipër jepen në Manualin ⁷⁹ e posaçëm për punimin e temës së diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Neni 66 i Rregullores së Departamentit ⁸⁰ të Pedagogjisë tregon procedura që ndiqet për zhvillimin dhe administrimin e provimit përfundimtar. Gjithashtu, në rregullore përcaktohet mënyra e ngritjes së komisionit të provimit, llogaritja e notës përfundimtare të studentit, lëndët që do të përfshihen në provim, si edhe formati i tezës së provimit përfundimtar.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Përgjegjësitë e Udhëheqësit të Diplomës përcaktohen në mënyrë të hollësishme në Manualin ⁸¹ për punimin e Diplomës (Master). Sipas manualit, udhëheqësi i diplomës duhet japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve, si edhe përgatitjen e punimit. Gjithashtu, Udhëheqësi i diplomës: <ul style="list-style-type: none"> ○ vlerëson rregullisht progresin e studentit kryesisht përmes raporteve të shkruara nga vetë studenti; ○ monitoron punën e studentit përkundrejt standardeve të kërkuara. Në fund të procesit, Udhëheqësi i diplomës konfirmon se punimi i plotëson kërkesat dhe standardet e kërkuara për fitimin e diplomës.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave	Nga konsultimet me dokumentacionin që lidhet me infrastrukturën fizike të UAMD-së, siç përmendet edhe në RVB, por edhe nga takimet e realizuara me studentët që ndjekin Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", u konstatua se në ambientet e UAMD-së janë në dispozicion të studentëve mjedise të mjaftueshme për të punuar

⁷⁹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Manual për punimin e diplomës Master Fakulteti i Edukimit UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.100. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁰ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë”, ASCAL, Evidenca nr.3.1.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸¹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Manual për punimin e diplomës Master Fakulteti i Edukimit UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.100. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




dhe fushës së studimit.	për përgatitjen e temës së diplomës: në veçanti mund të përmenden ambientet e bibliotekës ⁸² dhe të laboratorit të teknologjisë. Këto mjedise mund të përdoren nga studentët diplomantë si për përgatitjen e përgjithshme të temës së diplomës, ashtu edhe për hedhjen e të dhënave tabelore, grafike dhe të bërjes së analizave statistikore, në varësi të specifikave të temës së zgjedhur.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Rregullorja e Fakultetit ⁸⁴ të Edukimit (neni 76), parashikon se vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision me tre anëtarë, i ngritur nga njësia bazë dhe i miratuar ngadretuesi i njësisë kryesore. Vlerësimi përfundimtar i tezës llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit me sukses të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" dhe pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare ndaj universitetit, studenti pajiset me Diplomën dhe Suplementin ⁸⁵ e saj, si edhe nëse studenti e kërkon, atij i vendoset në dispozicion edhe një kopje të plotë të programit mësimor të zhvilluar përgjatë tre viteve.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UAMD-ja e përpunon informacionin e krijuar gjatë veprimtarisë së tij akademike dhe administrative sipas kërkesave specifike të përcaktuara në Rregulloren për Qarkullimin dhe Arshivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD ⁸⁶ . Çdo student i veçantë, mbi bazën e kërkesës së tij, mund të kërkojë në çdo kohë informacione që lidhen me jetën e tij

⁸² "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Manuali i përdorimit të Bibliotekës UAMD", ASCAL, Evidenca nr.86. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸³ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullorja e Bibliotekës UAMD", ASCAL, Evidenca nr.85. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁴ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Fakultetit të Edukimit", ASCAL, Evidenca nr.3.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁵ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Suplementi i ri Didaktikë", ASCAL, Evidenca nr.41. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁶ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD.", ASCAL, Evidenca nr.127. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	akademike, brenda kufijve të caktuara në aktet rregulatore të universitetit, si edhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arkivat në Republikën e Shqipërisë.			
Konkluzione	<i>Në përfundim të studimeve, për programin e studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", parashikohen dy mënyra alternative për vlerësimin përfundimtar të studentëve: Temë diplome ose Provim përfundimtar. Parashikohen rregulla shumë të qarta për mënyrën e përgatitjes, zhvillimit, si edhe të vlerësimit të këtyre dy mënyrave. Pas dhënies së provimit të përgjithshëm përfundimtar ose zhvillimit të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me Diplomë dhe Suplementin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nga vizitat në institucion, por edhe nga bisedat me personel akademik dhe me studentë që frekuentojnë Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", rezulton se praktikat profesionale ⁸⁷ të këtij programi realizohen nëpër institucionet arsimore të arsimit parauniversitar të arsimit 9-vjeçar pranë ZVA ⁸⁸ Durrës, bazuar në marrëveshjet që ka nënshkruar institucioni, ose praktikat profesionale mund të kryhen edhe në shkollat pranë vendbanimit të studentëve.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e	Për vetë specifikën e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", siç u theksua edhe në analizën e kriterit të mësipërm 1, Fakulteti i Edukimit dhe

⁸⁷"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e praktikës profesionale", ASCAL, Evidenca nr.102. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁸⁸ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës", ASCAL, Evidenca nr.67. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Departamenti i Pedagogjisë mundësojnë vetëm praktika profesionale pranë mjediseve të institucioneve arsimore parauniversitare deri në klasën e 9-të.</p> <p>Për këtë program studimi, nuk praktikohen praktika klinike apo stazhe me format të teknologjisë më të fundit.</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, nisur nga plani mësimor i programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", praktika profesionale vlerësohet me 6 kredite dhe zhvillohet bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Manualin e praktikës profesionale⁸⁹; ○ Rregullore e praktikës profesionale⁹⁰. <p>Ecuria e studentit gjatë zhvillimit të praktikës profesionale ndiqet nga mbikëqyrësi i universitetit (Pedagogu udhëheqës) dhe nga Mësuesi bashkëpunues. Gjithashtu, edhe vlerësimi i studentit për praktikën profesionale bëhet përmes vlerësimit të pedagogut udhëheqës dhe mësuesit bashkëpunues, por vlerësimin përfundimtar me notë e bën pedagogu udhëheqës.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rezultojnë se praktikrat profesionale, për studentët që ndjekin Programin e Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë", zhvillohen në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar të arsimit 9-vjeçar pranë ZVA Durrës, ose edhe në shkollat pranë vendbanimit të studentëve.</i></p> <p><i>Praktika profesionale vlerësohet me 6 kredite dhe vlerësimin përfundimtar e bën pedagogu udhëheqës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

⁸⁹ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Manual i praktikës profesionale", ASCAL, Evidenca nr.100/1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹⁰ "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e praktikës profesionale", ASCAL, Evidenca nr.102. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Quato



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet me pedagogët dhe administratën u konstatua se institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së UAMD në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor të personelit përkatës të FE, në rang njësie dhe fakulteti.</p> <p>Referuar dok (<i>Tabelat Program i Didaktikes per Akreditim_rotated</i>), në tre vitet e fundit akademike kemi këtë paraqitje të angazhimit të stafit akademik në këtë program studimi sipas kualifikimeve.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Grada/tituj</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc.</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>11</td> <td>1</td> <td>11</td> <td>1</td> <td>11</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table> <p>Rezulton se numri i PAE është më se i mjaftueshëm si sasi, por edhe si cilësi për zhvillimin me sukses të programit të studimit,</p>	Grada/tituj	2022-2023		2021-2022		2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	2	-	2	-	2	-	Prof.Asoc.	5	1	5	1	5	1	Dr./PhD	4	-	4	-	4	-	MSc	-	-	-	-	-	-	Total	11	1	11	1	11	1
Grada/tituj	2022-2023		2021-2022		2020-2021																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr	2	-	2	-	2	-																																											
Prof.Asoc.	5	1	5	1	5	1																																											
Dr./PhD	4	-	4	-	4	-																																											
MSc	-	-	-	-	-	-																																											
Total	11	1	11	1	11	1																																											
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në</p>	<p>Konstatohet se personeli akademik me kohë të plotë (PAE) që përgjigjet për mbarëvajtjen e zhvillimit të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë në "Master Profesional" në "Didaktikë" mbulon mbi 90% të ngarkesës mësimore të këtij programi studimi. Nga</p>																																																

<p>përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Tabela 12⁹¹ rezulton se ngarkesa mësimore e plotë e programit të studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në "Didaktikë" është 1710 orë mësimore. Shihet se personeli akademik mbulon ngarkesën mësimore për këtë program studimi në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, harton dhe zbaton procedura specifike për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit që fillojnë me shpalljen e thirrjes online, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së UAMD.</p> <p>Procedura e rekrutimit për personel të ri akademik bëhet mbi bazën e nevojave që paraqiten nga çdo njësi bazë (departament) e fakultetit, në fillim të vitit akademik. Nga evidencat dhe kontaktet me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore rezulton se punohet mbi bazën e kontratave vjetore si me pedagogët PAE, ashtu edhe me ata PAK, duke u mundësuar të gjithë punonjësve të angazhuar mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore ⁹²</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të</p>	<p>Konstatohet se çdo ndryshim në lidhje me nevojat e njësisë, propozohet nga DE, i dërgohet për miratim Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, shoqëruar me arsyetimin përkatës.</p> <p>Më pas institucioni harton procedura e kriterëve specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore në nivel qendror dhe institucional, duke i bërë ato publike.⁹³</p>

⁹¹"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Tabela 12 - Titullar pedagog-lëndë MP Didaktikë", ASCAL, Dokumenti nr.13. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹²UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik 2021-2022", ASCAL, Evidenca nr.44.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

⁹³"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Procedurë Rekrutimi", Evidenca nr.44.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




studimit.	
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit ka kapacitetet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor në auditorë/laboratorë të kompletuar dhe të mirëndriçuar, të pajisur me teknologji moderne.</p> <p>Institucioni ka disa zyra në dispozicion për stafin e pedagogëve të angazhuar në programin e studimit MP në "Didaktikë", ndërsa për stafin e angazhuar me kohë të pjesshme departamenti ka vënë në dispozicion 1 zyrë me 4 vende.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të Departamentit të Edukimit. Bazuar në kuadrin ligjor, ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik . Të dhënat e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik përfshijnë Cv, diplomën e universitetit, librezën e punës, diplomat e doktoratës, ato të titujve, librezat e siguracionit shëndetësor, ngarkesën mësimore si dhe angazhimin e pedagogëve në punën kërkimore shkencore, vit pas viti.</p> <p>Kujdes tregohet edhe për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit ndihmës dhe atij administrativ që përbëhet nga 11 punonjës të brendshëm dhe 1 të jashtëm</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e</p>	<p>Fakulteti i Edukimit, si edhe Departamenti i Pedagogjisë nënshkruajnë në mënyrë të vazhdueshme marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe organizata për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të ciklit të dytë⁹⁴ .</p> <p>Gjithashtu UAMD realizon shkëmbime studentore në kuadër të projektit "Erasmus+". Zhvillimi i praktikave mësimore, realizohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Personat përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e praktikës profesionale mësuesi mentor dhe pedagogu përgjegjës,</p>

⁹⁴"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës", ASCAL, Evidenca nr.67. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Edukt

OK

diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	ndihmojnë studentët në realizimin e praktikës pasive dhe më pas asaj aktive.			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktika profesionale e organizuar në shkollat e qytetit është realizuar mbi bazën e një marrëveshjeje me Zyrën vendoretë arsimit (ZVA), ndërsa tutorët në ndjekjen e praktikës janë pedagogë të programit të studimit MP “Didaktikë”. Nga Rregullorja e zhvillimit të praktikës profesionale ⁹⁵ , por edhe nga takimet me studentët pedagogët mentorë bashkëpunojnë me mësuesit e shkollave ku zhvillohet praktika për vlerësimin e punës së studentëve.			
Konkluzione	<i>Personeli akademik i angazhuar në realizimin e masterit “Didaktikë” nuk ka kualifikimin e duhur akademik, plotëson nevojat e studentëve në planin teorik praktik në një masë prej 90 % me personel akademik efektiv. Për realizimin e praktikave mësimore shihet marrëveshja që UAMD dhe Departamenti i Edukimit ka bërë me ZVA e qytetit Durrës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për	UAMD ka investuar në zgjerimin dhe përmirësimin e kapaciteteve fizike për auditorët dhe laboratorët mësimor dhe kërkimor; po ashtu ka investuar në tërheqjen e burimeve

⁹⁵“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e praktikës profesionale”, ASCAL, Evidenca nr.102. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>njerëzore për personel akademik me kohë të plotë; në kualifikimin e tyre profesional etj. Fakulteti i Edukimit ka në dispozicion auditorë bashkëkohorë të nevojshëm për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të programit të studimit⁹⁶</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit ka në funksion për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse godinën 1 në Kampusin Universitar. Kjo godinë ka mjedise të mjaftueshme mësimore për të siguruar veprimtarinë mësimore të programit të studimit.</p> <p>Fakulteti i Edukimit disponon rreth 1500 ulëse për të zhvilluar mësimin e programeve të ndryshme të studimit në të njëjtin orar mësimor. Për mirëfunksionimin dhe rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe nxënies, Departamenti i Pedagogjisë ka të pajisura të gjitha mjediset e tij mësimore si: laboratorin e auditorët me pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit si kompjuterë, projektorë (mjete audiovizive). Ato lehtësojnë aplikimin e metodave të reja ndërvepruese dhe komunikuese me studentët, duke u ndërthurur me procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Infrastruktura e universitetit përmban mjedise me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike për zhvillimin jo vetëm të mësimdhënies, por dhe të veprimtarive trajnuese dhe kërkimore shkencore. Për mirëfunksionimin dhe rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe nxënies, Departamenti i Pedagogjisë ka krijuar mundësinë duke i pajisur të gjitha mjediset e tij mësimore me pajisje moderne elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe duke i vënë në dispozicion të aftësimin teorik dhe praktik të objektivave formues të lëndëve dhe moduleve të veçanta të programit të studimit MP “Didaktikë”</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit,</p>	<p>Nga vizita në mjedise të ndryshme, konstatojmë se, klasat mësimore dhe laboratorët janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banka, karrige, pajisje</p>

⁹⁶“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Infrastruktura në funksion të programit të studimit”, ASCAL, Evidenca nr.73. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>teknologjike, tabela etj).</p> <p>Po kështu, gjatë vizitës në institucion, konstatoam se mjediset mësimore si zyrat, studiot, klasat, laboratorët, sallat e performancës, janë të pajisura me mjetet e nevojshme fizike, teknike dhe teknologjike, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimin teorik dhe praktik të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit, ka marrëveshje të shumta me partnerë të ndryshëm, gjithnjë në funksion të formimit të studentëve me zhvillimet bashkëkohore të mësimdhënies në mjediset e shkollave të qytetit.⁹⁷të cilat japin mundësi të realizimit të programeve profesionale sipas natyrës së lëndës.</p> <p>Krahas bibliotekës së universitetit, shihen edhe mjaft salla kompjuterësh , që shfrytëzohen nga studentët sipas programeve të studimit që u ofrohen. MP “Didaktikë” ka shumë pak studentë (4) dhe për ta mjediset janë jo vetëm të mjaftueshme, por në përputhje me numrin e tyre do të kërkoheshin mjedise më të vogla, të cilat do të ishin mbase edhe më efektive.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Gjithashtu konstatojmë se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

⁹⁷“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Mobilitetet e stafit akademik dhe studentëve D.Pedagogjisë”, ASCAL, Evidenca nr.68. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë Evidenca Nr. 73 Infrastruktura ne funksion te programit te studimit.Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit gjendet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit, si dhe realizimit të aktiviteteve të ndryshme. Nga analiza e syllabuseve të programit të studimit Master Profesional “Didaktikë” ka burime të shfrytëzueshme literature të viteve të fundit, e cila reflekton angazhimin shkencor të pedagogëve të atashuar me këtë program studimi.</p> <p>Krahasimi midis gjendjes fizike në bibliotekë dhe literaturës së shfrytëzuar nga pedagogët tregon se niveli i përgatitjes pedagogjike të lektorëve shkon më përtej numrit të kufizuar të titujve fizikë, (95 tituj nga fusha e Pedagogjisë) dhe (260 nga fusha e Psikologjisë), gjë që të çon drejt <i>rekomandimit se biblioteka duhet të fuqizohet më shumë me literaturë në gjuhë shqipe dhe të huaj.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Konstatohet se, njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.⁹⁸</p> <p>Për këtë strukturat përgjegjëse për zbatimin e programit përditësojnë syllabuset e të gjitha lëndëve të këtij programi studimi, gjithashtu zhvillohen konsultime edhe me bashkëpunëtorë apo partnerë nga tregu i punës për të pasqyruar çdo risi të fushës në përmbajtjen e programit.</p> <p>Më shumë duhej bërë nga lektorët e këtij programi studimi</p>

⁹⁸“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.87. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Guet

OK

	që nëpërmjet propozimeve të tyre të ndikonin në pasurimin e bibliotekës me literaturë pedagogjike e psikologjike të dhjetë vjeçarit të fundit, literaturë e cila është pjesë e rëndësishme e formimit sa më të plotë të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e Fakultetit, është në dispozicion të studentëve me një orar të përshtatshëm dhe garanton mundësinë e shfrytëzimit dhe aksesit për të gjithë studentët, që ndjekin programet e studimit në Fakultetin e Edukimit. ⁹⁹ Biblioteka ofron një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të studentëve mediatekën, por ka edhe sallat e leximit dhe kompjuterët që rrisin kapacitetin e shfrytëzimit të materialeve të ndryshme nga studentët
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka ka në fondin ¹⁰⁰ e saj tekste mësimore bazë, si edhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përshtatshme për kërkesat e programit të studimit MP në “Didaktikë”, por jo plotësisht të mjaftueshme. <i>Rekomandohet që Biblioteka të pasurohet me më shumë literaturë në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë të cilat janë pjesë e rëndësishme e formimit të studentëve të programit të studimit “Didaktikë”</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së	Bazuar në pikën 6.1 të Nenit 6 të Rregullores së Bibliotekës të gjithë studentëve të të gjitha programeve, apo cikleve të studimit iu garantohet akses pa pagesë në ato database on-line ku institucioni ka akses. ¹⁰¹

⁹⁹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Bibliotekës”, ASCAL, Evidenca nr.85. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁰“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.87. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰¹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Bibliotekës”, ASCAL, Evidenca nr.85. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

programit të studimit.	
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka ofron lehtësira dhe logjistikën e duhur që mundësojnë shfrytëzimin optimal të saj. Ajo përmban një sallë me fond të hapur, ku disponohen të gjitha pajisjet teknologjike që garantojnë akses të plotë për të gjithë studentët, si edhe një fond të mbyllur, bazuar në pikën 6.4 të Nenit 6 të rregullores së Bibliotekës.</p> <p>Biblioteka ka lidhje akses, i cili sigurohet brenda institucionit me anë të IP statike. Ajo ka vënë në shfrytëzim sistemin me bazë “ kod të hapur” dhe ka instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Sistemi i ri i quajtur “Koha”, “pa kosto” siguron informacion edhe jashtë ambienteve të universitetit. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit.</p> <p>Përveç përshkrimit bibliografik, katalogu ofron falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkime shkencore dhe disertacionet e stafit akademik të UAMD-së. Stafi akademik dhe studentët kanë akses në EBSCO, i cili ofron: mbi 170,000 Libra elektronike nga Oxford University Press, MIT Press, State University of NewYork Press, Cambridge University Press, University of California Press, McGill-Queen's University Press, Harvard University Press dhe shumë të tjera.) dhe mbi 6,600 periodikë dhe revista¹⁰²</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Çdo student dhe lektor ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studentëve iu është vënë në dispozicion kartela e regjistrimit me të dhënat personale dhe pajisjet me libeze anëtarësie. Studenti ka të drejtë të përdorë kompjuterët e sallave, për lundrim në burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik. Por ajo që ishte e evidente vërtetohej nga fakti se studentët përdornin më shumë bibliotekën online se sa atë fizike</p> <p>Oraret e shërbimit janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre. Oraret e hapjes së bibliotekës janë në funksion të nevojave, numrit të studentëve, apo edhe</p>

¹⁰²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Informacion për Bibliotekën Online”, ASCAL, Evidenca nr.86-89. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<p>kapaciteteve të saj, bazuar në pikën 6.4 të Nenit 6 të Rregullores së Bibliotekës ¹⁰³.</p> <p>Biblioteka ka si ditë pune të saj edhe ditën e shtunë, gjatë së cilës shihet një frekuentim më i madh i saj se në ditët e tjera të javës që mund të jenë të ngarkuara me punësime të ndryshme të studentëve.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka universitare punon sipas standardeve ndërkombëtare dhe udhëzimeve të përcaktuara nga IFLA (Federata Ndërkombëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të bibliotekave dhe Institucioneve, dhe politikave të brendshme të vetë bibliotekës.</p> <p>Biblioteka Shkencore e UAMD dhe e Fakultetit të Edukimit, e cila gjendet në mjediset e Universitetit dhe të Fakultetit të Edukimit, mbulon nevojat e studentëve për literaturë mësimi dhe kërkimi për të gjitha programet e studimit në UAMD. Pjesa më e madhe e materialeve që gjenden në këtë bibliotekë janë tekste dhe shumë pak leksione të lidhura dhe skripte. Biblioteka Shkencore përmban një inventar të pasur tekstesh e librash, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, të dobishme për shumë programe studimi, por jo në mënyrë specifike për MP "Didaktikë". Plani financiar i programit të studimit përmban zëra të veçantë për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës për programin e studimit</p> <p>Biblioteka dhe njësitë bazë kanë një komunikim të vazhdueshëm për pasurimin e fondit fizik dhe elektronik të fondit të titujve. Njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, inspektimin në bibliotekat e UAMD, si dhe në evidencat, konstatohet se, Biblioteka ka një fond të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe enciklopedi, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit.</i></p>

¹⁰³"UAMD", Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, "Rregullore e Bibliotekës", ASCAL, Evidenca nr.85. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Euro

	<p><i>Më me përparësi duhet punuar për pasurimin e literaturës pedagogjike si në gjuhë shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaj, pasi u konstatua se ka mangësi në tituj dhe në numër kopjesh.</i></p> <p><i>Rekomandohet që literatura pedagogjike dhe psikologjike të fuqizohet si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaj</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Sipas RVB, Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës (bazuar në rregulloren e tij Neni 7, 8, 9, 12), sekretaria e Fakultetit të Edukimit, si edhe Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit, disponojnë një sistem të menaxhimit të informacionit të studentëve në hyrje dhe në dalje.</p> <p>Nga intervistat me punonjësit e Burimeve Njerëzore, por edhe nga vizita në Sekretarinë mësimore u pa se UAMD disponon bazën e të dhënave që përmban informacionin e plotë mbi studentët të tilla si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e regjistrimit në universitet, datën e çregjistrimit dhe transferimit (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), datën e diplomimit, etj. Këtë bazë të dhënash e plotësojnë, përditësojnë dhe e disponojnë sekretaritë mësimore të secilit Fakultet dhe Sektori i IT dhe ia raportojnë organeve drejtuese kur nevojitet. Informacioni disponohet edhe në rrugë elektronike.</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit	Nga vizita në universitet, konstatuam gjithashtu se Zyra e Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa Departamenti monitoron dhe nxit aktivitetin

Geeta

OK

akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	mësimor dhe kërkimor-shkencor duke e ruajtur në dosje të veçanta.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Akcesi në dokumente dhe informacione garantohet si për personelin dhe studentët në mënyrë fizike dhe virtuale nëpërmjet web, mail, zonës së studentit në website, bazuar dhe në sistemin e përdorimit elektronik ¹⁰⁴
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	UAMD ka si platformë të vetën Platformën Pitagora ¹⁰⁵ që mundëson transmetimin e vlerësimit të dijeve të studentëve nga lektori te studenti në konfidencialitet dhe transparencë të plotë. Sekretaria ka një rol shumë aktiv në krijimin e rritjes së mundësive të studentëve për konsultim dhe komunikim me përgjegjësit e departamenteve dhe drejtuesve të tjerë të fakultetit (dekanë apo zv dekanë). Në takimin me studentët u konfirmuan marrëdhënie të mira dhe të hapura me personalin akademik për probleme të ndryshme të jetës së përditshme studentore.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Bazuar në rregulloret e ndryshme të UAMD, si ajo e Fakultetit të edukimit, e Departamentit të Pedagogjisë rezulton se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve dhe aktiviteteve të tjera mësimore. UAMD disponon dokumentacionin e nevojshëm me informacionet mbi stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm dhe për stafin administrativ.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e	Faqja web “www.uamd.edu.al” e institucionit përmban të gjitha informacionet mbi personelin akademik, programet e studimit, aktivitetet, projektet dhe njoftimet në gjuhën shqipe dhe atë angleze. ¹⁰⁶ Po në këtë faqe janë publikuar të dhëna në lidhje me

¹⁰⁴ UAMD. Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë . Evidenca Nr. 86 Biblioteka on-line. Manual përdorimi <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/> Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁵“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Manuali i përdorimit të Sistemit PITAGORA”, ASCAL, Evidenca nr.93-94. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁶ UAMD. Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë Evidenca Nr. 131 Te dhënat financiare mbi kostot ne Programet Bachelor: "Arsim Fillor", "Arsim Parashkollor", master: "Mësues per Arsim Fillor", "Didaktike", MSIA

ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	strukturën organizative, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendarin akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të fakultetit.			
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni disponon menaxhimin nëpërmjet sistemit Pitagora, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatohet, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	UAMD harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi duke u bazuar kryesisht në orët mësimore, shpenzimet operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj. Institucioni harton projekt buxhetin duke pasur si udhëheqje objektivat e universitetit, por edhe fakulteteve përkatëse të tij të cilat janë përcaktuar në funksion të përmbushjes së misionit të tij, si dhe synimeve dhe objektivave të përcaktuara në programet e ndryshme të studimit.

Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

60

Gueto

[Signature]

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grandet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka një plan financiar për këtë program studimi. Ky plan i financimit për këtë program studimi specifikon kualifikimin e stafit akademik nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve afatshkurtra dhe afatmesme, brenda dhe jashtë vendit; përmirësimi cilësor i laboratorëve shkencorë; rritjen e konkurrencën e stafit akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte, konferenca e kongrese kombëtare e ndërkombëtare, gjithashtu shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit¹⁰⁷</p> <p>Plani i financimit të programit të studimit përmban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orët mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Një zë i mbështetur nga UAMD, specifik krahasuar me universitetet e tjera të vendit është dhe mbështetja financiare e pedagogëve në botimin e punimeve të tyre në revistat ndërkombëtare me faktor impakti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Nga kontaktet me përfaqësues të zyrës së financës, u evidentua një kontroll i brendshëm sistematik në lidhje me gjendjen financiare të universitetit. Auditimi brendshëm në UAMD kryhet sipas udhëzimit për auditin e brendshëm në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të rregullta vjetore, të dokumentuara që dëshmojnë efektivitetin financiar të institucionit. Për këtë qëllim institucioni ndërton punën e tij vjetore bazuar në raportet e auditimit dhe të të dhënave financiare. Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik. Planifikimi i financimit për vitin pasardhës në funksion të garantimit të cilësisë së institucionit realizohet në përvojën paraprake të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni</p>	<p>Konstatuam se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni</p>

¹⁰⁷“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 8 - Personeli Didaktikë- të dhëna + kualifikim”, ASCAL, Dokumenti nr.10. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

<p>raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>dokumenton raportin financiar për një vit kalendarik dhe se në bilancin e vënë në dispozicion të GVJ, pasqyrohen të gjitha të dhënat për sa i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se UAMD garanton qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, por edhe për të ardhmen.</p> <p>Politikat e shpërndarjes së burimeve financiare hartohen/propozohen nga Senati Akademik dhe miratohen nga Bordi i Administrimit, në përputhshmëri të plote me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Vëmë në dukje se ndryshe nga dega e Arsimit fillor , MP “Didaktikë” ka një rënie të lartë të numrit të studentëve, rënie që rrezikon qëndrueshmërinë financiare të së ardhmes.</p> <p><i>Rekomandohet që të punohet për njohjen e vizionit të këtij programi studimi me mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, po ashtu me faqen online të Departamentit, në mënyrë që programi të mos shkojë drejt mbylljes</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, duke përmbytur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</p> <p><i>Është bërë një punë e lavdërueshme në aspektin e thithjes së shumë projekteve të përbashkëta me ndërkombëtarët të cilët kanë rritur edhe kapacitetet financiare të universitetit.</i></p> <p><i>Rekomandohet që Departamenti i Edukimit të punojë më shumë për njohjen vlerave të këtij programi studimi me drejtuesit dhe mësuesit e shkollave.</i></p>
<p>Shkalla e përmbyshjes së</p>	<p>Nuk Përmbyshet Përmbyshet Përmbyshet</p>

Gueto

lgr

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatorë.</p>	<p>Cikli i plotë akademik i studentëve është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe pas verifikimit të GVJ, por edhe sipas RVB mbështetet tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Ligji i arsimit të lartë” Nr. 80, Viti 2015¹⁰⁸ • VKM nr. 10, datë 07.04.2017¹⁰⁹ • VKM nr. 685, datë 25.08.2010 dhe në përshtatje me misionin dhe objektivat e tij në nenin 41, 45 të Rregullores së UAMD, nenit 57-61 i Statutit të Universitetit¹¹⁰ • Rregullore e UAMD¹¹¹ • Vendimin e Senatit Akademik "Për miratimin e kriterëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për vitin akademik 2020-2021 <p>Konstatohet që, institucioni ka ngritur strukturat dhe</p>

¹⁰⁸ UAMD. Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë Evidence-63 -Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22.07.2015/ Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁰⁹UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë/ https://www.unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf

¹¹⁰Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë / VKM nr. 10, date 07.04.2017; Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹¹Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë / Evidence 1 - Statuti UAMD, 2018 <https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/02/STATUTI-MIRATUAR-UAMD.pdf>

	komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullores së programit të studimit dhe Rregullores së studimeve në UAMD ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. Procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni me propozim nga DP dhe me miratim nga Senati Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit “MP. Didaktikë”, duke garantuar shanse të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si edhe për kandidatët studentë nga trojet, pakicat kombëtare, si dhe personat me aftësi të veçanta ¹¹² Sistemi i vlerësimit, sistemi i bursave apo përfitimi nga politikat lehtësuese është korrekt, transparent dhe pa dallim për të gjithë studentët. Studentët gëzojnë të drejtën e ankimimit, mbrojtjen e të drejtave dhe ruajtjen e pacenueshmërisë nga të gjitha instancat, po edhe nga çdo personel akademik.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve	Institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UMAD, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. UAMD, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentë për programet dhe mundësitë që ofron për studim. Rregullorja e ciklit e studimeve në UAMD ¹¹³ , ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e institucionit dhe funksionet e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore,

¹¹²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore për Studentët me Aftësi të Kufizura”, ASCAL, Evidenca nr.8. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹³“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës”, ASCAL, Evidenca nr.3. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>përkatëse.</p>	<p>vlerësimin dhe diplomimin.</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Guida e studentëve¹¹⁴, ku studenti gjen informacion të plotë mbi fakultetet, programet e studimit si dhe stafin akademik ○ Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit. ○ Kurrikulën e Programit të Studimit MP për Didaktikë¹¹⁵ ○ Rregullorja e Programit të Studimit MP për Didaktikë përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve ○ Gjithashtu, nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit MP Didaktikë, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UAMD dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. <p>Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës specifikojnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit Master Profesional Didaktikë.</p> <p>UAMD mundëson informimin e maturantëve mbi programet e studimit që ofron. Ky informacion përcillet nëpërmjet pjesëmarrjeve në evente që kanë në fokus këshillimin dhe orientimin e karrierës për maturantët si: Panairi "Ditët e orientimit të karrierës së maturantit", ku përfaqësuesit e institucionit ofrojnë këshillim dhe orientim për maturantët e interesuar mbi programet e studimit dhe mënyrat e aplikimit.</p>
-------------------	--

¹¹⁴“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Java e Orientimit dhe Guida e Studentit”, ASCAL, Evidenca nr.24. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁵“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Plani mësimor & Kurrikula Didaktikë, MP 2022”, ASCAL, Evidenca nr.35. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Pranimi në programet e studimeve bëhet sipas kriterëve të caktuara më parë në “Ligjin e arsimit të lartë” Nr. 80, Viti 2015;</p> <ul style="list-style-type: none"> • nenit 57-61 i Statutit të Universitetit; viti 2021; • Memo për “Transferimin e studentëve”, shkresa përcjellëse për aplikantët fitues sipas Rregullores së Diplomimit të FE. <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni me propozim të Departamentit të Pedagogjisë dhe miratim të Senatit Akademik, harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit Master Profesional “Didaktikë”, duke garantuar shanse të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta. Për të gjitha njoftimet e nevojshme rreth këtyre procedurave, studentët informohen nëpërmjet sekretarisë mësimore, afishimit në mjediset e fakultetit si dhe në faqen e internetit.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Plan- programi i studimit ¹¹⁶i bëhet e ditur çdo studenti që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UAMD-së, gjenden në çdo kohë plan programet për çdo program studimi. Por edhe sekretaritë përkatëse janë të gatshme të japin informacionin e duhur.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit të ofruara nga UAMD, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. UAMD, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet e studimit që ofron për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve</p>	<p>Në dosjen e programit të studimit, pranë departamentit të Pedagogjisë gjenden kriteret e hartuara dhe të publikuara për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Këto kriteret publikohen përpara fillimit të çdo viti akademik.</p>

¹¹⁶“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Plani mësimor & Kurrikula Didaktikë, MP 2022”, ASCAL, Evidenca nr.35. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




nga shtete të tjera.									
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UAMD ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë të komunitetit Romë, si dhe jep bursa për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke i publikuar ato në faqen e internetit								
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitat në institucion dhe evidencat, por edhe nga kontaktet me pedagogët dhe studentët, u konstatua se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UAMD, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online ne faqen zyrtare të ueb-it. Gjithashtu, konstatohet se UAMD ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve studentë, si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresat në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë, gjithnjë mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Institucioni ve në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve sipas neneve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nenet 8, 39, 52, 57, 59-63, 80 të Rregullores së FE nëpërmjet pajisjes së tyre me vërtetime notash sipas nenit 83-90 në Rregulloren e UAMD. <p>Koordinatori i programit organizon takime periodike me studentët e këtij programi për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për</p>

	<p>t'i informuar për çdo kërkesë dhe afat që ndikon në përparimin e tyre akademik.</p> <p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Guida e Studentit, prej së cilës studenti mund të informohet rreth kalendarit akademik, strukturës administrative, shkëmbimit studentor, jetës sociale të studentëve, klubeve studentore etj. ○ Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional "Didaktikë", përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. ○ Syllabuset e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit. ○ Plan Programi i studimit Master Profesional "Didaktikë". ○ Kalendari akademik në të cilin përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura, diplomimet etj.
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit MP për Didaktikë, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragu i kalimit të vitit akademik. Për ta hartohet dhe bëhet i qartë dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve. Procedurat e njohjes së lëndëve dhe transferimet janë të përcaktuara në nenin 47 të Rregullores së Fakultetit të Edukimit. Çdo student ekuivalenton studimet e veta paraprake përmes një komisioni ad-hoc, ngritur nga departamentet e ndryshme, sekretaritë mësimore, dhe ku i përcaktohet periudha dhe kohëzgjatja e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrja në veprimtaritë apo provimet mësimore, vlerësimi dhe diplomimi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Vlerësimi është periodik dhe studentët tashmë informohen nga personeli akademik edhe përmes njohjes me sylabuset lëndore apo modulare. Po kështu rezultatet e vlerësimit (pas përfundimit</p>

Queso

Ascal

<p>vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>të provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar) dhe ato të detyrave të kursit janë të detyruara të jepen në mënyrë transparente brenda një afati të caktuar kohor dhe me të drejtë ankimi. Referuar nenit 59, të Rregullores së FE, nenit 68 të Rregullores së UAMD, seksionit të “Kontrollit të Dijeve”¹¹⁷ në Syllabusin e çdo lënde, si dhe Nenit 2, 3 të Rregullores së Provimeve krijohen hapësirat e nevojshme për diskutimin e kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve nga studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në Rregulloren e studimeve në UAMD janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në programe të ndryshme të studimit. Janë pikërisht :</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Nenet 2-3 të Rregullores së Diplomimit, ● Neni 5 të Rregullores së Diplomimit përmes orientimit nga udhëheqësit e tyre, nëpërmjet shpalljeve në sekretari, takimeve orientuese me studentët për diplomimin dhe përmes faqes së internetit dhe rrjeteve sociale që qartësojnë dhe ndërgjegjësojnë studentët për alternativat e diplomimit të tyre, kohën dhe vlerësimin^{118,119}
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, u informuam se DP, në fillim të vitit të parë të studimeve nëpërmjet “Ditëve të hapura” informon kandidatët për studentë për strukturën dhe programet e studimit që institucioni ofron. Gjithashtu, gjatë javës së parë të studimeve¹²⁰ studentët e rinj prezantohen me stafin akademik të përfshirë në programin e studimit, të cilët në orët e para të tyre krahas leksionit, japin informacion rreth plan programit dhe orientojnë studentët në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, etj</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe evidencat, takimet me studentët dhe pedagogët konstatohet që MP Didaktikë, i detajuar me</i></p>

¹¹⁷“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 15 - Forma kontrolli njohurive 2023 (1)”, ASCAL, Dokumenti nr.15. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁸“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 6 - Cilësi stafi akademik për program + diploma MP Didaktikë”, ASCAL, Dokumenti nr.8. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹¹⁹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Model Formular për Vlerësimin e Temës së Diplomës të studentëve Master”, ASCAL, Evidenca nr.118. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁰“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Java e Orientimit dhe Guida e Studentit”, ASCAL, Evidenca nr.24. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Gueto

[Signature]

	<i>lëndët dhe modulet që përmban programi i studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores së UAMD dhe Guidës së studentëve, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe diplomimi, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UAMD dhe funksionet e tyre, si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Duke qenë se është detyrim dhe praktikë akademike dhe administrative që institucioni t'i informojë korrektësisht studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, UAMD është përpjekur ta zbatojë me korrektësi këtë standard. Në rrugë institucionale nëpërmjet strukturave përkatëse, po edhe nëpërmjet publikimeve, studentët njihen dhe japin mendime për mënyrën e organizimit, kohëzgjatjen dhe për përmbajtjen e programit të studimeve. Kjo praktikë është e pasqyruar në: <ul style="list-style-type: none"> • Nenet: 45, 57, 58, 60, 63,65, 66 të Rregullores së UAMD, • Nenet: 39, 48, 49, 51 të Rregullores së FE. Duhet përcaktuar më saktë në dokumentet e ndryshme të MP "Didaktikë" kohëzgjatja 2 vjet dhe shuma e krediteve të fituara 120.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe	Rezulton se në çdo fillim viti akademik studentët pajisen me materiale si Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor për Arsimin Fillor, ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së

G. G. G.

[Signature]

<p>dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragu i kalimit nga njëri vit në tjetrin. Këtij qëllimi i shërben edhe Guida e Studentit. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p>Gjithashtu lektorët tutorë të përcaktuar nga departamenti, informojnë studentët për kurset, syllabuset, detyrimet, mundësitë që institucioni ofron. Çdo lektor përpiqet të japë sa më shumë informacion lidhur me lëndën apo modulën e tij.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Njësia e Alumni dhe e Karrierës¹²¹:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Ndjek dhe organizon çështjet e karrierës të studentëve; ○ Ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve; ○ Bashkëpunon ngushtë me departamentet e fakulteteve për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve; ○ Ndjek ecurinë e realizimit të praktikave profesionale të studentëve; ○ Mban komunikim me organizatat e Tregut të Punës për të tërhequr mendime sa i takon përputhjes së diplomave të ofruara me tregun e punës, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave; ○ Përgatit propozimet për ndryshime dhe përmirësime të kurrikulave dhe ia paraqet për miratim strukturave përkatëse; ○ Është përgjegjëse për organizimin e panairove të punës; ○ Mban marrëdhënie të vazhdueshme me shoqatat¹²² apo organizime të tjera të ALUMNI dhe i mbështet ata në funksionimin e tyre. <p>Konstatohet se Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon</p>

¹²¹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore – Udhëzuesi i Karrierës”, ASCAL, Evidenca nr.21. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet”, ASCAL, Evidenca nr.22. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq> +“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Takime Raport Shoqata Alumni”, ASCAL, Evidenca nr.23. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Gueto

[Signature]

	<p>studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale të tregut të punës. Njësia e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zgjedhjen e karrierës së tyre, rritjen e kontakteve, vetëpunësimin dhe mundësitë për tregun e punës, si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme të institucionit me partnerë të ndryshëm të biznesit apo projekteve</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në çdo fillim viti të parë të studimeve, Departamenti i Pedagogjisë në bashkëpunim me Njësinë Alumni dhe të Karrierës organizojnë javën orientuese¹²³ me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, etj. Në faqen e internetit të UAMD gjendet i publikuar informacion i plotë për strukturat e UAMD dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekat, laboratorët etj.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi i informimit të brendshëm realizohet në forma formale e jo formale: afishimet, rrjetet sociale dhe profesionale, publikimet zyrtare në faqen zyrtare të UAMD janë format më të dukshme. Pra, informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes faqes online të universitetit, rrjeteve sociale dhe nëpërmjet adresave të email-it nëse studentët duan informacion më specifik.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet që UAMD publikon një informacion të plotë për strukturat e UAMD –së dhe funksionet e tyre, departamentet e ndryshme, auditorët, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët, sistemin elektronik, etj. Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme pedagogjike që institucioni organizon.</i></p> <p><i>Rezulton se në çdo fillim të vitit akademik studentëve u prezantohen materiale si Rregullorja e Programit të Studimit MP për Didaktikë , ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së</i></p>

¹²³“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Java e Orientimit dhe Guida e Studentit”, ASCAL, Evidenca nr.24. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




	<i>detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe diplomimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve për secilin program studimi që UAMD ofron. Departamenti i Pedagogjisë përmes evidencave për Programin e Studimit MP Didaktikë disponon raporte të rregullta vjetore për numrin e studentëve të diplomuar ¹²⁴ . Viti akademik 2022-2023 diplomoi 16 studentë, ndërsa këtë vit janë vetëm 4 të gatshëm për diplomim.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga vizita në sekretarinë mësimore konstatohet se ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalëse. Sekretaria gjithashtu administron dhe ruan rezultatet mësimore të studentëve në regjistrin themeltar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna menaxhohen edhe përmes Sistemit Pitagora. ¹²⁵ Sikurse u përmend më lart, Njësia e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e tyre. Rezulton se kjo njësi në bashkëpunim me sektorin mësimor, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike,

¹²⁴“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020”, ASCAL, Evidenca nr.110. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁵“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Manuali i përdorimit të Sistemit PITAGORA”, ASCAL, Evidenca nr.93-94. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Guato

	<p>mobilitetin e studentëve, si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit</p> <p>Referuar dok (Tabela 21 - Të dhëna studente nga sekretaria (1), të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike, paraqiten si vijon:</p> <p>Viti akademik 2020-2021 30 studentë;</p> <p>Viti akademik 2021-2022 11 studentë;</p> <p>Viti akademik 2022-2023 12 studentë;</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Konstatohet se institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse, për vlerësim, dokumentimin dhe saktësimin e informacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe Njësisë së Karrierës dhe Alumni¹²⁶.</p> <p>Institucioni disponon dhe siguron të gjitha të dhënat e nevojshme për studentët e regjistruar, bazuar kjo në deklarinë e rezultateve brenda afateve sipas Rregullores së Fakultetit të Edukimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullore e FE, neni: 69 i Rregullores së UAMD në lidhje me ecurinë akademike të studentëve, si dhe të çdo problematike (mbajtur me procesverbal) mbështetur në Rregulloren e FE.
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Të dhënat e studentëve menaxhohen nëpërmjet bazës së të dhënave vendosur në sekretarinë mësimore, mbështetur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e UAMD, nenet 81-83, • Nenin 74 pika 7 e Rregullores së FE dhe instancave më lart/ <p>Dekanati dhe personat e autorizuar kanë lehtësisht akses në këto databaza. Konstatohet se institucioni harton në mënyrë periodike raporte vjetore në rang njësie bazë. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe</p>

¹²⁶“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Të dhëna ALUMNI për punësimin e studentëve të UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.26.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Gueto

[Signature]

veprimtarinë e tyre përkatëse.	informacion në lidhje me mundësitë e punësimit, apo aktivitetet studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sipas RVB, Departamenti i Pedagogjisë ka filluar të bëjë studime të tregut të punës para apo pas diplomimit të studentëve, duke synuar evidentimin dhe përmirësimin e çdo problematike të hasur para, gjatë dhe pas daljes së studentëve nga auditorët. <i>Rekomandohet që analizat e tregut të punës të publikohen për të qenë si një model edhe për universitetet e tjera sepse në varësi të tyre ndërtohen edhe planet strategjike të këtyre institucioneve për përfshirjen e sa më shumë studentëve në këtë program studimi, që duket se ka predispozita rënie dhe humbje të kapaciteteve profesionale të punësuarra në vitet e fundit.</i>			
Konkluzione	Nga vizita dhe takimet në institucion, si dhe nga evidencat e shqyrtuara konstatohet që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalëse. Gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themeltar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Rekomandohet që analizat e tregut të punës të publikohen për të qenë si një model edhe për universitetet e tjera sepse në varësi të tyre ndërtohen edhe planet strategjike të këtyre institucioneve për përfshirjen e sa më shumë studentëve në këtë program studimi, që duket se ka predispozita rënie dhe humbje të kapaciteteve profesionale të punësuarra në vitet e fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Luot

<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatorë të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni zbaton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve¹²⁷ dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatorë të vetë institucionit të cilat parashikohen në :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nenet: 88-90 të Statutit të UAMD, të Rregullores së Fakultetit të Edukimit • Ligjin e Arsimit të Lartë <p>Studentët kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Bordin Administrativ, në Grupet e vlerësimit të brendshëm si dhe në NjSBC për vlerësimin e cilësisë së FE.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sipas RVB, Departamenti i Pedagogjisë në kuadrin e FE, garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje mbështetur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nenin 22, pika 1 të Rregullores së FE dhe referuar Shoqatës Alumni¹²⁸ të UAMD- së për përbërjen e Komisioneve të përhershme të Njësisë Kryesore, si dhe garanton që studentët të vlerësojnë procesin akademik nëpërmjet pyetësorit drejtuar studentëve, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së institucionit (mundësuar nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë). <p>UAMD organizon aktivitete që ndihmojnë studentët të menaxhojnë jetën studentore dhe të ndërveprojnë me njëri tjetrin për të arritur qëllime të përbashkëta sikurse janë klubet studentore: Klubi i Librit; Klubi i Artit; Klubi i Debatit; Klubi i Multimedias dhe Fotografisë; StartUp UAMD; Klubi për Shoqëri të Ndjeshme; Klubi i Juristëve të Rinj; Klubi Diplomatik; Klubi i Teknologjisë dhe i Inovacionit; Sustainability Club; Klubi i Shahut, etj të cilët çdo fillim viti akademik hartojnë kalendarin e tyre të aktiviteteve, që shpesh e publikojnë edhe në rrjetet sociale</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse</p>	<p>Nga vizita në institucion, në takimin me studentët, u njohëm me</p>

¹²⁷“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Vendim këshillat studentorë”, ASCAL, Evidenca nr.137.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq> +“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Vendim këshillat studentorë”, ASCAL, Evidenca nr.137.2. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹²⁸“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet”, ASCAL, Evidenca nr.22. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>faktin se ata janë të përfshirë në mënyrë indirekte, nëpërmjet realizimit të pyetësorëve për procesin mësimor dhe vlerësimin e lektorëve përmirësimin e cilësisë së zbatimit të kurrikulës në faza të ndryshme të studimit. Po ashtu studentët mbështesin punën e njësisë bazë për akreditimin dhe janë pjesë e GVB për hartimin e RVB për Programin e Studimit MP për Didaktikë</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e pyetësorit të studentëve, atyre iu është dhënë mundësia të japin mendimet e tyre mbi vlerat e barazisë dhe ndershmërisë së kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogëve përgjegjës.</p> <p>Nga kontaktet me studentët u konfirmua që NjsBC zhvillon pyetësorë në mënyrë periodike dhe disponon raportet që përdoren për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët. Në takimin me studentët, por edhe nga RVB u konkludua se ngarkesa mësimore e stafit akademik është përmirësuar vit pas viti. Orari mësimor, si dhe grafiku i provimeve shpërndahet në dy javë provimesh në mënyrë që studentët të mos zhvillojnë më shumë se dy provime në ditë.</p> <p><i>Rekomandohet që grafiku i provimeve të rishihet dhe të mos e tejkalojë sasinë e provimeve në më shumë se një në ditë.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në takimet në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet që studentët e UAMD janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillime dhe vlerësime mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Bordin Administrativ dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm. Studentët kanë krijuar një numër të madh klubesh shoqërore për të menaxhuar më mirë jetën e tyre sociale dhe për të përmirësuar marrëdhëniet me njëri tjetrin. Atyre u është dhënë mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogëve të çdo lënde.</p> <p><i>Rekomandohet që grafiku i provimeve të rishihet dhe të mos e tejkalojë sasinë e provimeve në më shumë se një në ditë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

Gueto



standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatorë të institucionit.</p>	<p>Njësia e ALUMNIT dhe Karrierës pranë UAMD ka për qëllim të ndihmojë studentët të zhvillojnë potencialin e tyre nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Këshillimit të Karrierës; ○ Rritjes së numrit të studentëve e të diplomuarve që punësohen në profesionin e tyre; ○ Të ndihmojë studentët në krijimin e lidhjeve me punëmarrësit potencialë; ○ Të shërbejë si burim rekrutimi për shumë organizata dhe institucione dhe të ofrojë shërbime trajnimi për biznese të ndryshme; ○ Njohjen me tregun e punës nga pikëpamja e kërkimit të punës së dëshiruar dhe aftësinë të paraqiten në këtë kërkim në mënyrën më profesionale të mundshme; ○ Mundësinë për të provuar punën e dëshiruar nëpërmjet praktikave të punës; ○ Mundësinë dhe aftësinë e ndërtimit të një rrjeti njohjesh në ambientet profesionale të tregut të punës.
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UAMD (http://www.uamd.edu.al/1), por edhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, regjistrimin në lëndët që duhet të japin provim etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohen nëpërmjet aksesit në sistemin Pitagora.</p>

Gueta

[Signature]

<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nga Njësia e këshillimit dhe karrierës dhe Shoqatës Alumni, UAMD. Institucioni bën informim të vazhdueshëm të studentëve për bashkëpunim me DAR për orientimin e praktikës profesionale.</p> <p>Njësia e Karrierës ka krijuar një rrjet me struktura të ndryshme dhe ofron shërbime nga të gjitha fushat siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Këshillim i Karrierës; ○ Organizim i workshopeve të ndryshme me tema specifike; ○ Mundësi praktike pranë rrjetit të shkollave të Kolegjit, mundësi për punësim të pjesshëm; ○ Mundësi bursash; ○ Programe trajnimi në fusha të caktuara; ○ Mundësi për ndjekjen e shkollave verore; ○ Aktivitete dhe panairë për mundësi punësimi; ○ Bashkëpunime me zyra partnere të sektorit publik dhe privat në shërbim të ofrimit të mundësive sa më të mira pranë studentëve.
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Njësia e Karrierës ka për mision të shërbejë për një orientim sa më të mirë të studentëve me tregun e punës, duke i mbështetur dhe inkurajuar në zhvillimin e plotë të potencialit të tyre, për një performancë më të mirë në shoqëri.</p> <p>Në kuadër të kësaj UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione¹²⁹ dhe kompani të ndryshme të fushave që ofrohen nga programet e studimit, të cilat ju japin mundësinë studentëve në kryerjen e praktikave profesionale dhe punësimin real të tyre gjatë dhe pas studimeve. Kjo zyrë edhe pas punësimit të studentëve vazhdon të mbajë një komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe me kompanitë partnere.</p> <p>Sipas RVB, për herë të parë, nën moton “Fillon këtu, shkon kudo!”, në vitin 2019. u zhvillua takimi i parë i Rrjetit Alumni të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Qëllimi i këtij takimi ishte jo vetëm ndarja e përvojave dhe arritjeve të tyre</p>

¹²⁹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.53. Parë më Nëntor 2023. gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	profesionale, por edhe krijimi i urave lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Në fund të aktivitetit u shpall fituesi i “Çmimit të Karrierës”. Tashmë në UAMD është bërë traditë transmetimi i Rubrikës “Alumni Talks” në rrjetet sociale të UAMD. “Alumni Talks” konsiston në intervistimin e Alumnit të suksesshëm të UAMD dhe synon që të sjellë përvojën dhe këshillat e Alumnit-ve për një rrugëtim të suksesshëm në karrierë.			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion, takimet me studentët dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet se studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, përfshirjen në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet Njesisë së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, kandidatët për student, dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të ndryshme që institucioni organizon. Institucioni gjurmon edhe punësimet e studentëve pas diplomimit për t’i paraqitur në statistikat dhe raportet e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton	Rritja e cilësisë së mësimdhënies prezantohet si një nga

Gueto

[Signature]

<p>udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>objektivat kryesorë të UAMD. Statuti i Universitetit “Aleksandër Moisiu” parashikon dispozita të veçanta për sa i përket sigurimit të cilësisë dhe garantimin e standardeve të kërkuara për mbarëvajtjen e procesit mësimor, bazuar në Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022.</p> <p>Departamenti dhe Drejtoria e Kurrikulës monitorojnë dhe rishikojnë programet e studimit, si dhe syllabuset e kurseve që ofrohen në programet e studimit që DP ofron. Përvoja e fituar nga lektorët gjatë programeve të shkëmbimit me universitete të vendeve të BE-së me te cilat universiteti “Aleksandër Moisiu” ka marrëveshje bashkëpunimi, si dhe metodologjitë bashkëkohore të përdorura nga këto universitete janë shfrytëzuar nga lektorët me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Projektet e ndryshme kanë tentuar që të përmirësojnë procesin e mësimdhënies dhe nxënies për ta bërë këtë sa më tërheqës për studentët, për të rritur angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre aktiv. Lektorët kanë në dispozicion mjete audiovizuale si laptop-e, video-projektorë, të cilët sipas RVB përdoren jo vetëm nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë përgatitjes dhe prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup apo ato individuale. Mësimdhënia me në qendër studentin është fokusi i orëve mësimore në programin e studimit MP “Didaktikë”. Ky program studimi është në përmirësim të vazhdueshëm siç përshkruhet edhe në planin strategjik të paraqitur.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë. Cilësia e mësimdhënies dhe performanca e stafit akademik vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat dhe mekanizmat që bazohen në nenin 2 dhe 10 të Rregullores së NjSBC, neni 80 i Statutit të Ri UAMD. Ky vlerësim kryhet përmes plotësimit nga ana e stafit akademik të formularit të vetëvlerësimit ku raportohet mbi arritjet shkencore të tyre gjatë vitit të fundit. Artikujt apo publikimet shkencore paraqiten në formularin e kërkimit shkencor. Gjithashtu performanca e stafit akademik vlerësohet edhe përmes pyetësorëve të plotësuar nga studentët. Zyra e Degës Mësimore monitoron prezencën e lektorëve në auditorë.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹³⁰(NjSBC) është përgjegjëse për organizimin dhe përpunimin e të dhënave që dalin nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve që iu drejtohen studentëve në lidhje me vlerësimin e formave të mësimdhënies, vlerësimin e dijeve të tyre, duke iu dhënë mundësi për ankimime dhe trajtim të tyre në rast nevojë. Ajo organizon në mënyrë periodike pyetësorët me studentët dhe i bën të ditur stafit akademik rezultatet që dalin pas përpunimit. Këto raportime më pas dërgohen edhe në strukturat drejtuese të UAMD-së. Analiza e pyetësorit diskutohet në departament, ku çdo pedagog ka të drejtën të njihet me vlerësimin që i bëhet nga studentët.</p> <p>Plotësimi i pyetësorëve zhvillohet dy herë gjatë vitit akademik; pra në përfundim të të dy semestrave, bazuar në nenin 6 të Rregullores së NjSBC.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Departamenti i Pedagogjisë, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit MP“Didaktikë”, bën publike rezultatet e vlerësimit nëpërmjet analizës vjetore të njësisë bazë.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila është përgjegjëse për hartimin dhe realizimin e pyetësorëve të studentëve, për përpunimin e tyre dhe për shpalljen e rezultateve, e realizon misionin e saj gjithashtu duke e bërë të gjithë procesin herë konfidencial, e herë publik, gjithnjë në ndihmë të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Një element shumë i rëndësishëm në UAMD është edhe shkëmbimi i përvojës në universitete partnere përmes programeve të shkëmbimit Erasums+, për mobilitet të stafit akademik duke vendosur theksin tek politikat integruese të stafit akademik.</p> <p><i>Rekomandohet që të zhvillohen analiza dhe mësim të hapura në bazë të përvojave që lektorët e Departamentit fitojnë në vizitat apo bashkëpunimet e tyre me kolegët dhe universitetet e huaja me të cilat kanë bashkëpunime.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të</p>	<p>Rezulton se, institucioni nëpërmjet Analizës Vjetore dhe asaj kërkimore-shkencore të Departamentit Pedagogjik, nxit lektorët që në grup të hartojnë plan veprimin për marrjen e masave për</p>

¹³⁰“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Kodi i cilësisë_Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”, ASCAL, Evidenca nr.61. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Gueto



praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	përmirësimin e mësimdhënies. Gjithashtu, feedbacku i marrë nga pyetëtorët e studentëve dhe i diskutuar në departament shërben si një strategji për përmirësimin e cilësisë referuar sugjerimeve të studentëve.			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë në Universitet dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon në mënyrë periodike pyetëtorët me studentët duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Takimet me përfaqësues të njësive të ndryshme, por edhe mjaft evidenca flasin për zbatim të udhëzimeve të MAS në lidhje me këtë standard.</i></p> <p><i>Rekomandohet që të zhvillohen analiza dhe mësim të hapura në bazë të përvojave që lektorët e Departamentit fitojnë në vizitat apo bashkëpunimet e tyre me kolegët dhe universitetet e huaja me të cilat kanë bashkëpunime.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatorë institucionale.	Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM nr.531 datë 11.09.2018; Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë; Manualin e ASCAL për Sistemin e Brendshëm të Cilësisërezulton se institucioni ka hartuar politikat e nevojshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, politika këto të shfaqura në përmbajtjen dhe kuadrin ligjor të institucionit. Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në të cilën përcakton se Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë funksionon

	<p>edhe si Njësi e Sigurimit të Brendshëm¹³¹</p> <p>Rezulton se, institucioni ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NjSBC-ja në nivel institucional bashkëpunon me Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë së brendshme.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Konstatohet që, institucioni ka ngritur Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm¹³².</p> <p>NjBSC-ja ka si mision parësor përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në UAMD duke përfshirë të gjithë aktorët e angazhuar në këtë proces të vazhdueshëm: studentët, bashkëpunimin me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Për përmbushjen dhe realizimin e këtij misioni ajo ofron ekspertizë pranë NjSBC-ve në nivel njësie kryesore ku saktëson dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare evropiane të sigurimit të cilësisë dhe synon t'i përshtatë ato në kontekstin institucional të UAMD-së.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që</p>	<p>Konstatohet që, institucioni nëpërmjet Paketës së Instrumenteve për Matjen e Cilësisë përdor disa instrumente matës për sigurimin e cilësisë siç janë pyetësorët për lëndën/modulin; pyetësorët lidhur me programin e studimit; pyetësorët për studentët e diplomuar në UAMD; pyetësorët për punëdhënësit; raportin e vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu dhe formularët e vlerësimit nga personeli akademik.</p> <p>Institucionet e arsimit të lartë ndjekin të gjitha udhëzimet për të realizuar Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet nga ASCAL, afatet, procedurat, llojet e</p>

¹³¹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë”, ASCAL, Evidenca nr.15. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin”, ASCAL, Evidenca nr.14. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>




<p>promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>akreditimit janë të përcaktuara në rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të cilësisë.¹²²</p> <p>UAMD i është nënshtruar procesit të Akreditimit Institucional në vitin 2016 dhe ka dalë e suksesshme duke u akredituar për 5 vite akademike në përfundim të procesit të akreditimit. Një akreditim i dytë u realizua gjatë vitit 2021. Programi “MP. Didaktikë” nuk i është nënshtruar asnjë akreditimi të mëparshëm</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatorë institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes si dhe arritjeve përmes sondazheve dhe raporteve vjetore që hartohen në rang institucional, si dhe në nivel njësie bazë për punën mësimore^{133/134}Sipas RVB, disa nga metodat që UAMD aplikon për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësim të cilësisë së mësimdhënies, - vlerësim të didaktikës, - vlerësimi i kurrikulës, syllabuseve, leksioneve, literaturës së përdorur, - vlerësimi i përvetësimit të të mësuarit, - vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, - vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, - vëzhgimi i procesit të mentorimit <p>Për arritje sa më të mira , Departamenti ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kurrikulave të këtij program studimi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat dhe takimet e zhvilluara në Departament, konstatohet se aktualisht, organizimi strukturor i brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë realizohet përmes Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve, si dhe sektorëve kryesorë të saj si Njësisë për</i></p>

¹³³“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020”, ASCAL, Evidenca nr.5. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁴“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti i vlerësimit të didaktikës”, ASCAL, Dokumenti nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

	<i>Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave dhe dokumenteve plotësuese rezulton se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve periodike të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili përfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti Pedagogjik ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit, veprimtaritë kërkimore shkencore duke analizuar faktorët e riskut për çdo kategori. Analiza SWOT shihet të jetë pjesë e vetëvlerësimit të brendshëm të lektorëve, por edhe raporteve vjetore të Departamentit të Pedagogjisë me qëllimin për të evidentuar risqet e zhvillimit të programit të studimit në të ardhmen e afërt.</p> <p>Departamenti i Pedagogjisë nëpërmjet proceseve të dokumentuara ka bërë shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të programit të ciklit të dytë. DP ka hartuar dhe është në proces implementimi të strategjive për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes mbledhjeve të hapura me stafin dhe studentët e programit të studimit Master Profesional Didaktikë. Në vitin akademik 2018-2019 hyri në veprim kurrikula e përmirësuar në përputhje me ligjin e ri të arsimit</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit,</p>	<p>Nga shqyrtimi i Planit të Zhvillimit të UAMD, Raporti vjetor i punës mësimore-shkencore i stafit akademik të DP-së, si dhe Raportit të brendshëm të vlerësimit, rezulton se institucioni ka përfshirë analizën SWOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e</p>

<p>motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>vlerësimin, rezultatet e pritshme, mangësitë dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> <p>UAMD çdo vit harton raporte përmbledhëse të veprimtarisë institucionale^{135/ 136}ku përfshihet procesi mësimor dhe analiza e kërkimit shkencor me të gjithë elementet e saj. Po kështu departamenti i Pedagogjisë harton në mënyrë të përvitshme një analizë të detyruar të punës mësimore, ku përfshihen mangësitë dhe sugjerimet përkatëse për t'i kapërcyer ato në mënyrë që të kemi një cilësi sa më të lartë. Këto raporte janë të përvitshme dhe në to publikohen rezultatet e vlerësimit</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Sipas RVB, UAMD duke u bazuar në rregulloren e miratuar, përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Disa nga metodat që UAMD¹³⁷aplikon për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, 2. vlerësim të didaktikës, 3 vlerësimi i kurrikulës, syllabuseve, leksioneve, literaturës së përdorur 4 vlerësimi i përvetësimit të të mësuarit, 5 vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, 6 vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, 7 vëzhgimi i procesit të mentorimit <p>Gjithashtu UAMD për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta^{138/ 139} si sondazhe të studentëve që ndjekin programin e studimit. Në përpjekje të vazhdueshme për ndër-kombëtarizim UAMD ka realizuar hartimin e kurrikulave të reja duke rifreskuar</p>

¹³⁵“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti i vlerësimit të didaktikës”, ASCAL, Dokumenti nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁶“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 6 - Cilësi stafi akademik për program + diploma MP Didaktikë”, ASCAL, Dokumenti nr.8. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁷“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015”, ASCAL, Evidenca nr.16. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹³⁸“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 24 - Njësia e SBC”, ASCAL, Dokumenti nr.25. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>“UAMD”,

¹³⁹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015”, ASCAL, Evidenca nr.16. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Guato



	<p>elementë të ndryshëm të programeve mësimore me risitë dhe eksperiencat më të mira. Rezultoni se institucioni në kuadër të vlerësimit të mbarëvajtjes të cilësisë së programit të studimit ka hartuar sondazhe dhe pyetësorë të ndryshëm që garantojnë monitorimin dhe zhvillimin e cilësisë së programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët; ○ Fokus grupet për vlerësimin e mësimdhënies; ○ Raportin e Vlerësimit të Programit të Studimit; ○ Analiza e punës mësimore dhe shkencore e FE; ○ Statistika për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik DP. <p>Janë realizuar pyetësorë nga Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë¹⁴⁰ që kanë për qëllim tërheqjen e mendimeve të studentëve¹⁴¹ për aspekte të programit të studimit dhe përmirësimit të tij. Një tjetër instrument i përdorur nga Institucioni është edhe sondazhi institucional.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në takimet me grupe dhe individë, por edhe nga evidencat, konstatojmë se institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet raporteve vjetore, si dhe përdor metoda dhe instrumente të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p>

¹⁴⁰“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Plani mësimor & Kurrikula Didaktikë, MP 2022”, ASCAL, Evidenca nr.35. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq> +“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Suplementi i ri Didaktikë”, ASCAL, Evidenca nr.41. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴¹“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 22- Studentë të aktivizuar”, ASCAL, Dokumenti nr.23. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nëpërmjet analizës SWOT të Strategjisë së Zhvillimit të UAMD-së si dhe Raportit vjetor të punës mësimore-shkencore të stafit akademik të DP, institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Statuti i UAMD¹⁴²-së, lejon IAL-në të hartojë procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë ku pranë Drejtorisë së Kurrikulave Standardeve dhe Cilësisë, është organizuar dhe funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,¹⁴³ e cila synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Evidentimin e problematikave të lidhura me mësimin. ○ Evidentimin dhe ndjekjen e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies. ○ Sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. ○ Vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. ○ Organizimin dhe ndjekjen e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo programi studimi. ○ Vlerësimin e performancës së stafit akademik <p>Në vlerësim përfshihen stafi akademik, ai ndihmës akademik, administrata, studentët dhe komuniteti i të diplomuarve.</p>

¹⁴²“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Statuti i Universitetit 'Aleksandër Moisiu' Durrës”, ASCAL, Evidenca nr.1. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴³“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Tabela 24 - Njësia e SBC”, ASCAL, Dokumenti nr.25. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>“UAMD”,

Guat

fel

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rezultojnë se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Të drejtat dhe detyrimet e aktorëve kryesorë si njësitë, studentët, palët e tjera të angazhuara në sigurimin e cilësisë së programit janë të përcaktuara qartë në rregulloren e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.¹⁴⁴</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në Rregulloren e Studimeve në UAMD¹⁴⁵.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UAMD-së, në Rregulloren e Studimeve, në kuotat e përcaktuara për studentët, në përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale dhe në grupet e vlerësimit, rezultojnë se, institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve.</p> <p>Të gjitha strukturat e institucionit bashkëveprojnë dhe sigurojnë një shërbim cilësor në nxitjen dhe rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik, studentët dhe personeli administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të</p>

¹⁴⁴“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë-Erishikuar”, ASCAL, Evidenca nr.13. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁵“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës”, ASCAL, Evidenca nr.3. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

fuoto

[Signature]

	<p>Institucionit dhe me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë që ka përgjegjësinë institucionale. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me institucionet arsimore për realizimin e praktikave profesionale, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus + luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij program studimi.</p> <p>Në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshihen dhe ekspertë të jashtëm. Bashkëpunëtorët kontribuojnë me mendimet dhe ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së institucionit. UAMD ashtu edhe Fakulteti i Edukimit apo Departamenti i Pedagogjisë konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta gjatë organizimit të takimeve apo konferencave me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit MP “Didaktikë”.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të këtij program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i></p> <p><i>Rekomandohet që raportet e vlerësimit të brendshëm të diskutohen, përpara se të publikohen duke pasur kujdes jo vetëm për përmbajtjen e tyre, por edhe për anën formale e cila shihet në shkrimin sipas rregullave të drejtshkrimit, ndërtimit të fjalive, përdorimit të germës ë, etj. Një këndvështrim i tillë edukon edhe studentët me modelin e punës që duhet të bëjnë përkrah pedagogëve të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Konstatohet se institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit e tjerë në faqen zyrtare të UAMD. Në politikat institucionale që zbaton UAMD, rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, dhe gjithë informacioni që disponohet për këtë qellim, publikohet në dokumentacionet përkatëse apo online duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale për të gjithë individët e përfshirë në këtë proces.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Planin Strategjik të FE-së, të DP-së, të programit të studimit, Rregulloren në rang njësie bazë, Rregulloren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale¹⁴⁶</p> <p>Programi i transparencës në UAMD¹⁴⁷, i cili i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të universitetit, është përgatitur në përputhje me nenin 7 të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe garanton rregullat bazë të organizimit dhe funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezulton, gjithashtu, se në Planin Strategjik të FE-së, të DP-së, të programit të studimit si dhe në analizën vjetore mësimore shkencore paraqitet një plan masash për përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Programi i studimit MP “Didaktikë” nuk i është nënshtruar më parë procesit të akreditimit. Megjithatë, çdo shtator nga Përgjegjësi i njësisë bazë bëhet analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor, tek e cila</p>

¹⁴⁶ UAMD, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë. Evidence-98-Programi i Transparencës së UAMD. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

¹⁴⁷ “UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Kodi i Etikës UAMD”, ASCAL, Evidenca nr.4. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Euro

	paraqiten problematikat e vitit që ka përfunduar dhe objektivat që duhet të arrihen. Si rrjedhim, kjo analizë shoqërohet edhe me një plan masash që adresojnë problematikat e evidentuara.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Konstatohet se, institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në raportet e vlerësimit të brendshëm dhe analizën e tyre në departament. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Institucionit është përgjegjës para Senatit për punën e tij. Ai diskuton dhe vendos për çështje të fushës së menaxhimit të cilësisë dhe promovon, kooperon dhe monitoron aktivitetet e sigurimit të cilësisë në universitet dhe anëtarët e tij. Për më tepër ai monitoron vetëvlerësimin impaktin dhe procedurat e vlerësimit të universitetit. Komisioni përgatit propozime për aktivitete për cilësinë, duke përfshirë prioritetet që duhet të kryhen në universitet në vitin pasardhës që vijnë si rezultat i impaktit që kanë dhënë masat e marra gjatë vitit paraardhës akademik. Propozimet e tij ia prezanton Senatit Akademik. ¹⁴⁸			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i RVB-së dhe diskutimet e realizuara nga takimi me Zyrën e Kurrikulës, rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti. Departamenti i Pedagogjisë gjithashtu organizon veprimtari informuese me studentët e secilit cikël të studimeve dhe garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programit të studimit MP "Didaktikë".			
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni ka hartuar Planin Strategjik Institucional, Rregulloren në rang njësie bazë, Rregulloren për programin e studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹⁴⁸“UAMD”, Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Pedagogjisë, “Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës”, ASCAL, Evidenca nr.3. Parë më Nëntor 2023, gjendet në: <https://ascal.al/sq>

Gusto

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Çmado

[Signature]

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në
“Didaktikë” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Ky program akademik ka në thelb të tij, shtyllën për një mësimdhënie shkencore, dhe përfshin një periudhë dy vjeçare studimi, me 120 kredite. Objektivi i tij kryesor është t'i pajisë pjesëmarrësit me një kuptim gjithëpërfshirës të parimeve dhe metodologjive themelore në fushën e didaktikës.
2. Duke pasur një histori institucionale disa vjeçare, programi ka pësuar një përmirësim për t'u përafruar me standardet arsimore dhe për t'u përshtatur në mënyrë dinamike me kërkesat e mjedisit akademik kombëtar.
3. Personeli akademik, demonstroi një frymë të gjerë bashkëpunimi e cila karakterizohet dhe nga përvoja e gjerë në fushën përkatëse. Ky kombinim siguron një mësimdhënie dhe mentorim të plotë për studentët.
4. Duke pranuar prirjet heterogjene të grupit të studentëve dhe kërkesat vazhdimisht të luhatshme të peizazhit profesional, kurrikula e programit demonstroi fleksibilitet dhe përshtatshmëri. Kjo qasje pedagogjike synon të plotësojë nevojat e individualizuara të pjesëmarrësve, duke përafruar trajektoret e tyre arsimore me aftësitë dhe njohuritë e kërkuara nga tregu i punës në sferën e didaktikës.
5. Një aspekt integral i brendshëm i këtij programi akademik është theksi i tij i shtuar në kërkimin shkencor. Programi kultivon në mënyrë aktive një mjedis të favorshëm për përpjekje intensive kërkimore, duke nxitur në këtë mënyrë një kulturë që inkurajon si pedagogët ashtu edhe studentët të kontribuojnë në aplikimin e njohurive në praktikë, brenda sferës së edukimit.
6. Programi përfiton nga një infrastrukturë gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme, e cila u mundëson studentëve akses në sallat e leksioneve, seminarët dhe objektet ndihmëse të domosdoshme për një përvojë efektive të të mësuarit. Kjo dispozitë strategjike siguron që studentët të jenë të pajisur me mjetet dhe burimet e nevojshme thelbësore për arritjet e tyre akademike.

Pika të dobëta:

1. Rritja e mobilitetit të studentëve: Në përgjigje të natyrës globale të arsimit, ka një theks në rritjen e mobilitetit të studentëve brenda programeve akademike. Ky trend përfshin lehtësimin e mundësive për studentët që të përfshihen në programe shkëmbimi, praktika dhe projekte bashkëpunuese nëpër institucione të ndryshme arsimore, si në nivel kombëtar ashtu edhe

Gesta

[Signature]

ndërkombëtar. Duke inkurajuar mobilitetin e studentëve, institucionet e arsimit të lartë, synojnë të ofrojnë një përvojë arsimore më të larmishme dhe më të pasur. Ky ekspozim ndaj mjediseve, kulturave dhe perspektivave të ndryshme mësimore jo vetëm që zgjeron horizontet e studentëve, por gjithashtu nxit një ndjenjë përshtatjeje dhe ndërgjegjësimi global, cilësi thelbësore në botën e sotme.

2. Rifreskimi i literaturës në funksion të programit të studimit: Mbajtja aktuale dhe relevante e literaturës së programit të studimit është thelbësore për të siguruar që studentët të ekspozohen ndaj përparimeve dhe njohurive më të fundit në fushën e tyre. Kjo përfshin një proces të vazhdueshëm të përditësimit të materialeve të leximit, teksteve mësimore dhe burimeve të referencës për të pasqyruar kërkimet, metodologjitë dhe tendencat më të fundit. Personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë, luan një rol kyç në këtë proces duke duke integruar literaturë të re që përputhet me objektivat e programit të studimit. Ky angazhim për të rifreskuar literaturën jo vetëm që rrit përvojën akademike, duke u ofruar studentëve njohuri të fundit, por gjithashtu rrënjës një kulturë të kuriozitetit akademik dhe të menduarit kritik, duke i përgatitur ata për sfidat e ushtrimit të profesionit.

Rekomandime:

Rekomandohet që Rregullorja e Departamentit të Pedagogjisë, si edhe Rregullorja e Programit të Studimit të përditësohen në përputhje me kërkesat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

Rekomandohet plotësimi dhe saktësimi i nenit 36 të Rregullores së Departamentit të Pedagogjisë, në të cilën duhet të shtohet shprehja se *në fushën akademike të Departamentit të Pedagogjisë përfshihen edhe programe ndërdisiplinore që përfshijnë arsimin.*

Rekomandohet që Departamenti i Pedagogjisë që të ndërtojë/përshtatë një sistem kodifikimi të lëndëve, në bazë të të cilit të bëhet kodifikimi i çdo lënde të veçantë.

Rekomandohet caktimi dhe emërimi i një personeli akademik efektiv për rolin e Koordinatorit të Programit të Studimit.

Rekomandohet përditësimi/amendimi i Rregullores së Programit të Studimit me qëllim përditësimin e saj në bazë të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë...” dhe të akteve të shumta nënligjore të dala në zbatim të ligjit, ku të përfshihen edhe objektivat e programit të studimit në fushën e kërkimit shkencor.

Rekomandohet që përdorimi i metodave të reja të mësimdhënies dhe të të nxëniet të përfshihet në Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë, si edhe në Rregulloren e Programit të Studimit.

Rekomandohet rregullimi i nenit 54 të Rregullores së Departamentit të Pedagogjisë, në atë mënyrë që të mundësohet harmonizimi i nenit 54 të saj me nenin 17 të rregullores së programit të studimit.

Rekomandohet që të punohet për të shtuar përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve nga ky program studimi.

Rekomandohet shtimi i titujve nga fusha e pedagogjisë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. Numri 95 + 260 (sasia e titujve nga fusha e pedagogjisë dhe e psikologjisë në bibliotekë) është shumë i ulët për MP “Didaktikë” ku pedagogjia është fushë dominante e dijes.

Rekomandohet që të punohet për njohjen e vizionit të këtij programi studimi me mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, po ashtu edhe me faqen online të Departamentit, në mënyrë që programi të mos shkojë drejt mbylljes.

Rekomandohet që grafiku i provimeve të rishihet dhe të mos e tejkalojë sasinë e provimeve në më shumë se një në ditë.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Gusto'.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'F. ...'.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program, Professional Master in "Didactics" offered by the Institution of Higher Education "Aleksandër Moisiu", Durrës

Strengths and affirmations

1. This academic program has at its core, the pillar for a scientific teaching, and includes a two-year period of study, with 120 credits. Its main objective is to equip participants with a comprehensive understanding of the fundamental principles and methodologies in the field of didactics.
2. Having an institutional history of several years, the program has undergone an improvement to align with educational standards and dynamically adapt to the demands of the national academic environment.
3. The academic staff demonstrates a broad spirit of cooperation, which is also characterized by extensive experience in the relevant field. This combination provides comprehensive teaching and mentoring for students.
4. Acknowledging the heterogeneous tendencies of the student body and the constantly fluctuating demands of the professional landscape, the program's curriculum demonstrates flexibility and adaptability. This pedagogical approach aims to meet the individualized needs of the participants, aligning their educational trajectories with the skills and knowledge required by the labor market in the field of didactics.
5. An integral aspect of this academic program is its increased emphasis on scientific research. The program actively cultivates an environment conducive to intensive research endeavors, thereby fostering a culture that encourages both faculty and students to contribute to the application of knowledge to practice within the realm of education.
6. The program benefits from a comprehensive and sustainable infrastructure which enables students to access the lecture halls, seminars and ancillary facilities necessary for an effective learning experience. This strategic provision ensures that students are equipped with the necessary tools and resources essential for their academic achievement.

Weaknesses

1. **Increasing Student Mobility:** In response to the global nature of education, there is a growing emphasis on enhancing student mobility within academic programs. This trend involves facilitating opportunities for students to participate in exchange programs, internships, and collaborative projects across various educational institutions, both nationally and internationally. By promoting student mobility, higher education institutions aim to provide a more diverse and enriching educational experience. This exposure to different learning environments, cultures, and



perspectives not only broadens students' horizons but also fosters a sense of adaptability and global awareness — essential qualities in today's interconnected world.

2. Refreshing the Literature in Function of the Study Program: Maintaining the currency and relevance of study program literature is crucial to ensure that students are exposed to the latest advances and knowledge in their field. This involves a continuous process of updating reading materials, textbooks, and reference resources to reflect the most recent research, methodologies, and trends. Both permanent and contracted academic staff play a key role in this process by integrating new literature that aligns with the study program's objectives. This commitment to refreshing the literature not only enhances the academic experience, providing students with cutting-edge knowledge, but also instills a culture of academic curiosity and critical thinking, preparing them for the challenges of the teaching profession.

Recommendation

1. It is recommended that the Regulations of the Department of Pedagogy and the Regulations of the Study Program be updated in alignment with the requirements outlined in the National Education Strategy for the period 2021-2025.
2. To enhance clarity, it is advisable to supplement Article 36 of the Regulation of the Department of Pedagogy, explicitly stating that the academic scope of the Department includes interdisciplinary programs that incorporate education.
3. The Department of Pedagogy is encouraged to establish or adapt a subject codification system, providing a codification for each individual subject.
4. For the position of Study Program Coordinator, it is recommended to assign an effective academic staff member.
5. The Regulation of the Study Program should be updated to align with Law 80/2015 "On Higher Education" and related by-laws, encompassing the objectives of the program with a focus on scientific research.
6. Inclusion of new teaching and learning methods is advised in both the Regulations of the Department of Pedagogy and the Regulations of the Study Program.
7. Adjustments to Article 54 of the Regulation of the Department of Pedagogy are suggested to harmonize it with Article 17 of the study program regulation.
8. Efforts should be intensified to enhance student mobility from this study program.



9. To address the insufficient number of titles in the field of pedagogy and psychology in the library (95 + 260), additional titles in Albanian and other languages are recommended, especially considering pedagogy's dominant role in the MP "Didactics."
10. Recognition of the study program's vision among teachers, school leaders, and on the department's online website is recommended to prevent the potential closure of the program.
11. A revision of the exam schedule is advised, ensuring it does not exceed the capacity to manage exams within a single day.

Eusta

OK

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X




